



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2025

I PANELIT ZGJEDHOR
PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2025

**I PANELIT ZGJEDHOR
PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP
Prishtinë, 2026**

**Rruga “ Migjeni “Ndërtesa e ish
Bankës së Lubjanës kati –I-, 10000
Prishtinë**

info@pzap-ks.org

www.pzap-ks.org

038/211-242

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
HYRJE	9
01. PJESA E PARË.....	10
VIZIONI	10
MISIONI	10
KORNIZA LIGJORE	10
ORGANOGRAMI I PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA ²	13
AKTIVITETE DHE ÇËSHTJET E VENDOSURA NGA PZAP-I, NË VITIN 2025	14
PËRFAQËSIMI INSTITUCIONAL I PZAP-IT	15
PUNËTORITË E PZAP-it	19
AKTIVITETET E SEKRETARIATIT	23
BUXHETI DHE FINANCAT	26
SHPENZIMET	29
SHPENZIMI PAGA DHE SHTESA 2025	31
SHPENZIMI MALLRA DHE SHËRBIME 2025	32
TË HYRAT	33
SHËRBIMET E PËRGJITHSHME	35
02. PJESA E DYTË.....	39
ZHVILLIMI I PROCESIT TË ZGJEDHJEVE TË PËRGJITHSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS TË MBAJTURA MË 9 SHKURT 2025	39
03. PJESA E TRETË	52
ZHVILLIMI I PROCESIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË MBAJTURA ME 12 TETOR 2025	52
04. PJESA E KATËRT	65
ZHVILLIMI I PROCESIT TË ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS TË MBAJTURA ME 28 DHJETOR 2025	65
PËRFUNDIM	75
SFIDAT NË USHTRIMIN E MANDATIT LIGJOR	75

LISTA E SHKURTESAVE

PZAP	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
SPZAP	Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
LZP	Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme
LZL	Ligji për Zgjedhjet Lokale
ZYRA	Zyra për Regjistrimin, Certifikim dhe Kontroll Financiar
SP	Subjekti Politik
QNR	Qendra e Numërimit dhe e Rezultateve
QKN	Qendra Komunale të Numërimit
QV	Qendra e Votimit
KKZ	Komisioni Komunal i Zgjedhjeve
KVV	Këshilli i Vendvotimit
SIMFK	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës
SIMBNJ/HRMIS	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
SMVP	Sistemi i Menaxhimit të Vijueshmërisë në Punë
SMA	Sistemi për Menaxhimin e Ankesave
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
SNKSP	Standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik
SZHMB	Sistemi i zhvillimit të menaxhimit të buxhetit
KPM	Komisioni i Pavarur i Mediave
KMSHK	Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
LV	Lista e Votuesve

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti Vjetor i Punës për vitin 2025 është dokumenti bazë që paraqet dhe shpalos veprimtarinë e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), si organ i përhershëm dhe i pavarur, kompetent për vendosjen mbi ankesat e paraqitura që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe me rregullat zgjedhore në fuqi.

Raporti vjetor pasqyron aktivitetet e PZAP-it të realizuara në periudhën nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2025, duke përfshirë proceset zgjedhore, sfidat dhe të arriturat e institucionit gjatë kësaj periudhe raportuese.

Ky raport paraqet dëshmi të punës së PZAP-it, e cila është realizuar me përkushtim dhe profesionalizëm nga anëtarët e panelit të PZAP-it dhe stafi administrativ i Sekretariatit. Në raport janë të përfshira: puna e paneleve në shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave të paraqitura nga subjektet politike; rezultatet e arritura nga departamentet; aktivitetet e prokurimit; çështjet që lidhen me menaxhimin e personelit; shpenzimet buxhetore; komunikimi dhe bashkëpunimi me akterët zgjedhorë; si dhe të dhëna mbi pjesëmarrjen e anëtarëve të PZAP-it dhe stafit të Sekretariatit në konferenca dhe punëtori të ndryshme.

Gjatë periudhës raportuese, PZAP ka punuar për të realizuar objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara me Planin Strategjik të PZAP-it 2024–2027, Planin e Punës 2025, si dhe me Planet e Veprimit për proceset zgjedhore, përfshirë:

- Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09 Shkurt 2025;
- Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025;
- Raundin e Dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 09 nëntor 2025; dhe
- Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 28 dhjetor 2025.

Në kuadër të këtyre proceseve zgjedhore, puna e PZAP-së, pasqyrohet sipas tabelës së mëposhtme.

Proceset Zgjedhore gjatë vitit 2025	Ankesa	Vendimet e ankimura në Gjykatën Supreme	Gjobat e shqiptuara	Ankesat e dërguara në KPM-KMSH
Zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me 09 Shkurt 2025	642	47	651,100 €	17/2
Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, të mbajtura me 12 Tetor 2025	440	42	124,700 €	5
Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me 28 Dhjetor 2025	80	12	162,000€	
Gjithsejtë	1162	101	937,800 €	24

PZAP-ja e ka njoftuar me shkrim Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për çdo proces zgjedhor lidhur me gjobat e paguara nga subjektet politike që kanë aplikuar për certifikim, për të dhënat e personave të cilët me vendimet e PZAP-it, i'u është ndaluar e drejta e pjesëmarrjes në zgjedhje si kandidatë apo si anëtarë të trupave menaxhuese të zgjedhjeve, dhe e ka njoftuar për mbylljen e procesit të vendimmarrjes së të gjitha ankesave, ku për qëllim kishte ndërmarrjen e hapave procedurale në lidhje me publikimin e rezultateve përfundimtare dhe certifikimin e zgjedhjeve nga KQZ.

Po ashtu PZAP-i, ka shpërndarë Formularët të ankesave në gjuhën zyrtare në të gjitha Qendrat e Votimit (QV), ku qytetaret kanë mundur të parashtrojnë ankesa për parregullsitë eventuale në ditën e votimit.

Gjatë kësaj periudhe përbërja e panelit ka pësuar ndryshime, ku paneli është plotësuar me dy anëtar të emëruar nga KGJK sipas vendimit Nr.23/2025 të datës 24 janar 2025, me gjyqtaren Violeta Husaj Rugova dhe gjyqtarin Ramush Bardiqi.

Si rezultat i të gjeturave të identifikuara gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09.02.2025, dhe në zbatim të rekomandimeve të dala nga raporti përfundimtar i Bashkimit Evropian, PZAP ka plotësuar/ndryshuar Rregulloren për Parashtrimin dhe Vendosjen e Ankesave.

Gjatë kësaj periudhe është përgatitur Raporti Vjetor i Punës së PZAP-it për vitin 2024, raporti Gjashtëmujorë për periudhën Janar - Qershor 2025, i cili me pas është dërguar në KGJK, si dhe është përgatitur historiku ndër vite i PZAP-së për tu bërë pjesë e historikut të përgatitur nga KGJK.

Zhvillimi i bashkëpunimit ndërinstitutional përmes takimeve me institucione vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë KQZ-në, KGJK-në, misionet diplomatike, ambasadorin e Bashkimit Evropian, ambasadorin e OSBE-së, ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, përfaqësuesit e ekipit ligjor të Bashkimit Evropian për vëzhgimin e zgjedhjeve, përfaqësuesit e Këshillit të Evropës, etj.

Ndër aktivitetet e rëndësishme të realizuara gjatë kësaj periudhe janë mbajtja e punëtorive të përbashkëta me OSBE-në, ku janë diskutuar raportet e organizatave ndërkombëtare, përfshirë Raportin e Misionit të Bashkimit Evropian për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, si dhe Raportin e organizatës Demokracia në Veprim, me qëllim të shqyrtimit të të gjeturave dhe rekomandimeve të dala nga zgjedhjet. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe, është edhe mbajtja e një punëtorie të përbashkët me menaxhmentin e Komisionit të Pavarur për Media (KPM). Kjo punëtori kishte për qëllim qartësimin e kompetencave institucionale në trajtimin e ankesave lidhur me gjuhën e urrejtjes apo gjuhën e papërshtatshme të përdorur në studiot televizive nga subjektet politike në zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09 Shkurt 2025.

Bazuar në Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës nr. 08/L-193 për vitin 2025, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP) i është ndarë buxheti fillestar në vlerë prej 262,421 €. Gjatë vitit buxhetor, ky buxhet ka pësuar ndryshime, si rezultat i të cilave, në

fund të vitit buxheti i miratuar ka qenë në shumën prej 231,703 €. Nga ky buxhet përfundimtar, shpenzimet e realizuara kanë arritur vlerën prej 227,157 €, që përfaqëson rreth 98% të buxhetit total të miratuar pas ndryshimeve buxhetore, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), në Raportin e Auditimit të PZAP-it për vitin financiar 2024, të datës 19.06.2025, ka konstatuar se Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2024 paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

HYRJE

Në pajtim me nenin 115, paragrafët 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka obligim ligjor që Raportin Vjetor t'ia dorëzojë Këshillit Gjyqësor të Kosovës, më së largu deri më 1 mars të vitit pasues pas mbajtjes së zgjedhjeve, ku me pas Këshilli Gjyqësor i Kosovës sipas paragrafit 8 të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës i dorëzon Kuvendit të Republikës së Kosovës raportin vjetor për gjendjen në sistemin gjyqësor, përfshirë një kapitull të veçantë edhe përmbledhjen e punës së Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për vitin zgjedhor përkatës. Raporti Vjetor i PZAP-ës për vitin 2025 është strukturuar në katër pjesë kryesore, i cili paraqet një pasqyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse të veprimtarisë së Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) në të cilin janë pasqyruar edhe proceset zgjedhore, dhe atë:

Pjesa e parë ofron të dhëna të përgjithshme mbi Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, duke përfshirë organizimin dhe funksionimin institucional, aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit 2025, të arriturat kryesore, indikatorët financiarë, përkatësisht të hyrat dhe shpenzimet në kuadër të buxhetit të miratuar për këtë vit, aspektet e bashkëpunimit institucional, komunikimet e zhvilluara me institucionet dhe palët relevante.

Pjesa e dytë - Zgjedhjet Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 9 shkurt 2025.

Në këtë pjesë trajtohet në mënyrë të detajuar procesi shqyrtimit dhe vendimmarrjes lidhur me ankesat e paraqitura nga subjektet politike dhe palët e tjera të interesuara, në të gjitha fazat e procesit zgjedhor, në kuadër të Zgjedhjeve të Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 9 shkurt 2025. Kjo pjesë analizon natyrën e shkeljeve të konstatuara, masat e ndërmarra dhe sanksionet e shqiptuara, përfshirë gjokat, si dhe ankesat e paraqitura në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të PZAP-it. Po ashtu në këtë pjesë pasqyrohen rastet specifike të identifikuara gjatë këtij procesi zgjedhor.

Pjesa e tretë - Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 12 Tetor 2025, dhe zgjedhjet për Raundin e dytë për Kryetar të Komunave të mbajtura me 9 Nëntor 2025.

Në këtë pjesë paraqiten në mënyrë gjithëpërfshirëse aktivitetet e ndërmarra nga PZAP në kuadër të procesit zgjedhor, përfshirë shqyrtimin dhe vendimmarrjen lidhur me ankesat e paraqitura në të gjitha fazat procesit të dy raundeve që lidhen me Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, dhe Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 9 nëntor 2025, natyrën e shkeljeve të konstatuara, shqiptimin e sanksioneve, përfshirë gjokat, ankesat e paraqitura në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të PZAP-it, si dhe rastet specifike të identifikuara gjatë këtij procesi zgjedhor.

Pjesa e katërt - Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me 28 Dhjetor 2025

Në këtë pjesë paraqitet një pasqyrë gjithëpërfshirëse e aktiviteteve të ndërmarra nga PZAP në kuadër të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo pjesë përfshin të dhëna mbi numrin e ankesave të paraqitura, mënyrën e vendimmarrjes së PZAP-it, analizën e natyrës së shkeljeve të konstatuara, shqiptimin e sanksioneve, përfshirë gjokat, si dhe ankesat e paraqitura në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të PZAP-it, dhe rastet specifike të identifikuara gjatë këtij procesi zgjedhor.

01. PJESA E PARË

VIZIONI

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP, është dhe synon të jetë një institucion i besueshëm, i qëndrueshëm, i fuqizuar dhe inovativ, që punon për forcimin e drejtësisë zgjedhore.

MISIONI

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa PZAP, me qëllim të fuqizimit të demokracisë, është i përkushtuar që me profesionalizëm, paanshmëri dhe me kohë të zgjidhë kontestet zgjedhore për të siguruar të drejtat për të gjithë akterët lidhur me procesin zgjedhor.

PZAP, është i përkushtuar për përmbushjen me besnikëri të detyrave në përputhshmëri me kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës. Të gjitha vendimet i merr në baza etike duke u bazuar në të gjitha provat për të promovuar besimin publik në aktivitetet e tij në përputhshmëri me ligjin, të pa ndikuara nga jashtë. Është i hapur dhe është përgjegjës për veprimtarinë që zhvillon si dhe siguron qasje për marrjen e informatave për të gjitha palët e interesuara.

KORNIZA LIGJORE

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa/PZAP, në zbatim të mandatit dhe ushtrimit të kompetencave të tij, bazohet në kornizën ligjore primare dhe sekondare, për të siguruar të drejtat e të gjithë qytetarëve me të drejtë vote, subjekteve politike, dhe akterëve tjerë të cilët kanë të drejtë të ankohen lidhur me kontestet zgjedhore. Vendimet e PZAP-it, janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga KQZ-ja, përveç në rast se nga ankesa e parashtruar në Gjykatën Supreme e Kosovës, vendoset ndryshe. PZAP e realizon mandatin e tij përmes kornizës ligjore primare bazike, por që nuk kufizohet vetëm në të;

- Ligjit Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës;
- Ligjit Nr. 03/L-072, Për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës;
- Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative;
- Rregulloren Nr. 01/2025 Për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave;
- Rregullat e miratuara nga KGJK;
- Rregullat Zgjedhore të KQZ-së.

Mandati dhe Përbërja e PZAP-it

Sipas Ligjit Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës emëron kryesuesin e PZAP-së, nga radha e gjykatësve të Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa anëtarët emërohen nga radha e gjykatësve të Gjykatës së Apelit dhe anëtarët e Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, të cilët shërbejnë për një mandat të ripërtitëshëm prej katër (4) viteve. Në bazë të këtij ligji PZAP-i, përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtar duke përfshirë kryesuesin e PZAP-it.¹

Me miratimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP-së) Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me natyrën e punës së PZAP-it, ka miratuar akt të veçantë për kushtet dhe përvojën specifike të gjyqtarëve që mund të emërohen në PZAP.

Në rast se pozita e kryesuesit apo një anëtar i mbetet e zbrazët, Këshilli Gjyqësor i Kosovës emëron një person në atë pozitë brenda tridhjetë (30) ditëve. PZAP-i mund të mblidhet në seanca të ndara me nga së paku tre (3) anëtar.

Me buxhetin e vitit 2025 të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, PZAP-i, ka të lejuara/aprovuara 21 pozita, prej tyre: 1 (një) Kryesues të PZAP-it, 10 (dhjetë) anëtar të panelit të PZAP-it, 1 (një) Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-it dhe 9 (nëntë) zyrtarë të sekretariatit të PZAP-it.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa/PZAP, aktualisht përbehet nga kryesuesi dhe anëtarët si vijon:

1. Zenel Leku, Kryesues i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Supreme të Kosovës
2. Kymete Kicaj, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
3. Hajriz Hoti, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
4. Arsim Hamzaj, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
5. Hidajete Gashi Alaj, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
6. Skender Çoçaj, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
7. Bujar Muzaqi, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
8. Kujtim Pasuli, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës së Apelit – Prishtinë,
9. Violeta Husaj Rugova, anëtare e PZAP-it/Gjyqtare e Gjykatës së Apelit-Prishtinë,
10. Ramush Bardiqi, anëtar i PZAP-it/Gjyqtar i Gjykatës Komerciale/Dhomat e Shkallës së Dytë – Prishtinë.

Struktura organizative Sekretariatit të PZAP-it

Në përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësi ligjore që ka, PZAP-i mbështetet nga udhëheqësi i Sekretariatit dhe zyrtarë të tjerë të cilit ofrojnë përkrahje profesionale dhe teknike për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e tij të përcaktuara me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

Organizimi i brendshëm i Sekretariatit të PZAP-it, ka qenë i rregulluar me Rregulloren Nr.01/2018 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në PZAP. Sipas kësaj Rregullore, struktura e Sekretariatit përbehej prej dhjetë (10) zyrtarëve, përfshi drejtorin e përgjithshëm të Sekretariatit dhe dy departamenteve.

¹ Anëtar i PZAP-it Nikolla Petronijeviq, Gjyqtar i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, për shkak se në vitin 2022 ka dhënë dorëheqje nga pozita e gjyqtarit në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga KGJK-ja, lidhur me dorëheqjen e paraqitur nga ana e tij, i njëjti evidentohet si anëtar i PZAP-it.

KGJK, më datë 30.09.2024, kishte miratuar Rregulloren Nr. 13/2024 Për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, mirëpo e njëjta rregullore nuk është zbatuar për arsye se MFPT, nuk e ka miratuar vlerësimin financiar dhe ka pasur implikime buxhetore për zbatimin e saj. Në këtë rregullore janë të parapara edhe 7 pozita të reja në SPZAP, për të cilat pozita duhet aprovim nga MFPT.

Ndërsa Këshilli Gjyqësor i Kosovës, (KGJK) në mbledhjen e mbajtur me datë 30.09.2025, ka miratuar Rregulloren Nr.12/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.13/2024 për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa. Me këtë rregullore është përcaktuar se jo më vonë se tre (3) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, Sekretariati i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, duhet të nxjerr akt emërimet e reja, për të gjitha pozitat në SPZAP, duke i harmonizuar me titujt e përcaktuar me këtë rregullore, si dhe aktet normative për klasifikimin e vendeve të punës për nëpunësit civil në administratën e sistemit gjyqësor.

Zyra e Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-it

Sekretariati ndihmon PZAP-in, në ushtrimin e përgjegjësiave dhe funksioneve të tij në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-228, Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Sekretariati i PZAP-it, ka një udhëheqës të zyrës, respektivisht Drejtorin e Sekretariatit i cili, nën drejtimin e Kryesuesit të PZAP-it, është përgjegjës për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e PZAP-it. Zyrën e Drejtorit të Sekretariatit e përbejnë Drejtori dhe Asistentja Ekzekutive.


Departamenti Ligjor

Ndër përgjegjësitë kryesore që ka, mbështet punën profesionale të PZAP-it dhe Sekretariatit, duke siguruar kryerjen e shërbimeve juridike, këshilluese, për të siguruar menaxhim efektiv, identifikimin e nevojave për hartimin e politikës së legjislacionit primar dhe sekondar duke siguruar respektimin e teknikave dhe standardeve, të ofroj mbështetje profesionale menaxhmentit të institucionit dhe paneleve të gjyqtareve në shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, si dhe ka për qëllim ndërmarrjen e veprimeve dhe aktiviteteve të duhura për të gjitha çështjet administrative të ndërlidhura me funksionimin e Departamentit. Në kuadër të këtij departamenti janë të punësuar katër (4) zyrtarë, përfshirë Drejtorin e departamentit ligjor dhe tre (3) zyrtar të lartë ligjor, ku secili prej tyre është pjesë e njërit nga panelet e PZAP-it.

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Është përgjegjës për menaxhimin dhe përkujdesjen e burimeve materiale, ofrimin e shërbimeve administrative dhe teknike, menaxhimin e financave dhe buxhetit, Teknologjisë Informative si dhe logjistikën e PZAP-it. Në kuadër të këtij departamenti janë të punësuar katër (4) zyrtarë Drejtori për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme, Zyrtar i Teknologjisë Informative, Zyrtar i Lartë për Përkthime dhe Zyrtar për Transport.

ORGANOGRAMI I PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA²




Përfaqësimi gjinor dhe i komuniteteve në kuadër të PZAP

Nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të PZAP-it, deri në fund të këtij viti duke përfshirë kryesuesin është dhjetë (10), prej tyre shtatë (7) janë të gjinisë mashkullore ose 70% ndërsa tre (3) janë të gjinisë femërore ose 30%. Kurse sa i përket përkatësisë etnike dhjetë (10) janë shqiptarë ose 91%, ndërsa një (1) anëtarë PZAP-it ose 9%, është nga radhët e komuniteteve jo shumicë.

² Ky organogram pasqyron organizimin e brendshëm të Sekretariatit të PZAP-it, sipas Rregullores Nr.12/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Nr.13/2024 për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e pozitave të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, të miratuar nga KGJK me datën 30.09.2025.

Përfaqësimi gjinor dhe i komuniteteve në kuadër të Sekretariatit të PZAP-it.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në Sekretariatit të PZAP-it, është 9 zyrtarë, prej tyre pesë (5) janë të gjinisë mashkullore ose 50%, ndërsa katër (4) janë të gjinisë femërore ose 40%, kurse sa i përket përkatësisë etnike tetë (8) janë shqiptarë ose 80% ndërsa një (1) i punësuar është i përkatësisë boshnjake, ose 10%. Në fund të këtij viti numri i të punësuarve në Sekretariatit të PZAP-it, është nëntë (9).



Ankesat e paraqitura jashtë procesit zgjedhor

Gjatë këtij viti, i cili për PZAP-in, ka qenë vit zgjedhor, janë paraqitur edhe ankesa që nuk kanë pasur të bëjnë me proceset zgjedhore të vitit 2025. Një ndër këto ankesa, e cila nuk ka ndërlidhje me proceset zgjedhore, është paraqitur nga përfaqësuesi i iniciativës politike Kosovski Savez, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me të cilin kësaj iniciative i ishte refuzuar kërkesa për regjistrim si parti politike në KQZ.

PZAP-i, me Vendimin Anr.53/2025, e ka aprovuar si të bazuar këtë ankesë dhe ka urdhëruar Zyrën për Regjistrim, Certifikim dhe Kontroll Financiar të Subjekteve Politike në KQZ që iniciativën politike Kosovski Savez ta regjistrojë si parti politike dhe ta përfshijë në regjistrin e partive politike të regjistruara në Republikën e Kosovës.

AKTIVITETE DHE ÇËSHTJET E VENDOSURA NGA PZAP-I, NË VITIN 2025

Takimet e rregullta të PZAP-it

Gjatë vitit 2025, janë mbajtur dymbëdhjetë takime/mbledhje të rregullta të PZAP-it, në të cilat takime janë shqyrtuar, diskutuar dhe janë nxjerr vendime në përputhje me LZP-në, si dhe ligjet tjera të aplikueshme. Janë marrë vendime administrative për çështje të ndryshme që janë në mandatin e institucionit, në kuptim të menaxhimit të gjithmbarshëm të punës së PZAP dhe Sekretariatit.

Vendimet kryesore të marra nga PZAP-i- gjatë vitit 2025

- Miratimi i Planit të Punës së PZAP-it për vitin 2025;
- Miratimi i Raportit të Punës së PZAP-it për vitin 2024;
- Emërimin e tre paneleve në përbërje të tre anëtarëve, për shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave për proceset zgjedhore;
- Miratimi i Planit të Rekrutimit për angazhimin e stafit të përkohshëm për proceset zgjedhore;
- Miratimi i Rregullores 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave;
- Miratimi i Raportit gjashtë mujor (Janar-Qershor) të punës së PZAP-it për vitin 2025;
- Vazhdimi i mandatit të U.D Drejtorit të Sekretariatit të PZAP-it;
- Miratimi i Planit të Veprimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09 Shkurt 2025;
- Miratimi i Planit të Veprimit për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025;
- Miratimi i Planit të Veprimit për Raundin e Dytë të Zgjedhjeve për Kryetar të Komunave, të datës 09 Nëntor 2025;
- Miratimi i Planit të Veprimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të datës 28 Dhjetor 2025



Mbajtja e takimeve nga Paneli i PZAP-it

PËRFAQËSIMI INSTITUCIONAL I PZAP-IT

• Takimet dhe Punëtoritë e PZAP-it

PZAP edhe gjatë vitit 2025 ka vazhduar me zhvillimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, përmes takimeve me institucione vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë KQZ-në, KGJK-në, KPM-në, OSBE-në, misionet diplomatike, ambasadorin e Bashkimit Evropian, ambasadorin e OSBE-së, ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, përfaqësuesit e ekipit ligjor të Bashkimit Evropian për vëzhgimin e zgjedhjeve, përfaqësuesit e Këshillit të Evropës, etj. Për më tepër, Kryesuesi i PZAP-it, z. Zenel Leku, së bashku me ushtruesin e detyrës së drejtorit të Sekretariatit të PZAP-it, kanë zhvilluar një sërë takimesh me akterë të rëndësishëm në funksion të përgatitjeve për procesin zgjedhor, përfshirë:

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërinstitucional, janë mbajtur dy takime lidhur me Planin Operacional të Sigurisë, të organizuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në kuadër të përgatitjeve për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe Zgjedhjet Lokale 2025.

Në kuadër të takimeve me përfaqësues vendor dhe ndërkombëtar janë mbajtur takime si në vijim:

. Takimi me përfaqësuesit e ekipit ligjor të Bashkimit Evropian,

Në kuadër të bashkëpunimit, përfaqësuesit e ekipit ligjor të Bashkimit Evropian, të kryesuar nga znj. Eirini SKOUZOU me bashkëpunëtor, ku për mision kanë përcjelljen e ecures së aspektit ligjor të zgjedhjeve, janë mbajtur disa takime me përfaqësuesit e PZAP-së, për të gjitha proceset zgjedhore në Kosovë në vitin 2025. PZAP-ja e ka njoftuar ekipin vëzhgues me kompetencat e reja ligjore, përgjegjësitë institucionale në kuadër të KGJK-së, sfidat buxhetore, transparencën dhe komunikimin e vazhduar me palët e interesuara. Vëzhgimi i zgjedhjeve dhe informatat e marra nga PZAP ishin të domosdoshme për përgatitjen e raporteve zgjedhore që përgatiten nga BE për çdo proces zgjedhor.



Takimi me përfaqësuesit e ekipit ligjor të Bashkimit Evropian

. Takimi me ambasadorin e Bashkimit Evropian

Përfaqësuesit e PZAP-së, në një takim me ambasadorin e Bashkimit Evropian në Kosovë, z. Aivo Orav, prezantuan rolin dhe rëndësinë e institucionit në administrimin dhe shqyrtimin e ankesave në kuadër të proceseve zgjedhore.

Gjatë takimit, ambasadori Orav vlerësoi lart punën e PZAP-së, duke theksuar se institucioni po dëshmon pavarësi institucionale, profesionalizëm dhe transparencë në vendimmarrje, çka kontribuon drejtpërdrejt në forcimin e integritetit dhe kredibilitetit të procesit zgjedhor. Ky vlerësim u konsiderua si një inkurajim dhe mbështetje për përkushtimin e vazhdueshëm të PZAP-së në zbatimin e mandatit të saj.

Mbështetja dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm i BE-së me PZAP-në janë reflektuar edhe në raportin e fundit të Bashkimit Evropian për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 9 shkurt 2025.



Takimi me ambasadorin e Bashkimit Evropian, z. Aivo Orav

. Takimi me ambasadorin e OSBE-së

Në kuadër të dialogut të rregullt ndërinstitutional, Kryesuesi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), z. Zenel Leku, priti në takim ambasadorin e OSBE-së, z. Gerard McGurk, me të cilin biseduan për rëndësinë dhe sfidat e PZAP-it me të cilat ballafaqohet, në veçanti gjatë proceseve zgjedhore. Bashkëpunimi dhe mbështetje e vazhdueshme e OSBE -se gjatë dhe jashtë procesit zgjedhor, lehtësojnë punën e PZAP- së në ushtrimin e zbatimit kuadrit ligjor.



Takimi me ambasadorin e OSBE-së

Në kuadër të takimeve me Misionin e OSBE-së në Kosovë kemi edhe takimin me z. Jim Rogan, konsulent i angazhuar për të asistuar në hartimin e Kornizës së ardhshme Strategjike (2026–2030), 7 nëntor 2025. Qëllimi i këtij takimi ishte të mblidhen perspektiva që do të ndihmojnë në hartimin e Kornizës Strategjike të OSBE-se për vitet 2026–2030, duke identifikuar fushat ku angazhimi i OSBE-së mbetet më i rëndësishëm dhe i nevojshëm brenda mandatit.

Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga OSBE, me temën “Barazia gjinore në proceset zgjedhore”

- **Takimi me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar**

Takim me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, z. Jonathan Hargreaves, ishte një mundësi për të diskutuar me për së afërmi për rëndësinë e punës së PZAP-së gjatë proceseve zgjedhore, në veçanti pavarësia në ushtrimin e mandatit ligjor, profesionalizmi dhe transparenca, si dhe për sfidat me të cilat përballlet ky institucion.



Takim me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar

- **Takim me Komisionin e Pavarur të Mediave**, me rastin e hapjes së Asamblesë së 24-të Plenare të Rrjetit Mesdhetar të Autoriteteve Rregullatore (MNRA), e cila këtë vit është mbajtur në Prishtinë. Ky takim i hapjes ka shërbyer për bashkëbisedim dhe ndarje idesh me përfaqësues të institucioneve partnere, rregullatorë dhe personalitete që kontribuojnë në zhvillimin e ekosistemit rregullator të mediave.
- **Takim me delegacionin e Kongresit** të përbërë nga gjashtë anëtarë të Kongresit të udhëhequr nga z. Dominique Leveque (Kryetar i Ay-Champagne, Francë), dhe një eksperte, znj. Nathania Tabone (Malta), për të shkëmbyer mendime rreth zgjedhjeve të ardhshme lokale dhe për të diskutuar çështjet e ankimit dhe procedurat e apelimit.
- **Takim i Kryesuesit të PZAP-it** me delegacionin e vëzhguesve ndërpartiakë, nga Asambleja Parlamentare.
- **Pjesëmarrje e anëtarëve të PZAP-së në takimin e mbajtur me Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve**, me përfaqësues të Departamentit për Mbrojtjen e Demokracisë Vendore të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.
- **Pjesëmarrje në takimin e organizuar nga Demokraci Plus (D+) dhe Westminster Foundation for Democracy (WFD)**, në publikimin e raportit “Kostoja e Politikës në Kosovë”.
- **Pjesëmarrje në takimin me Misionin e Vëzhgimit të Zgjedhjeve**, me përfaqësues të Departamentit për Mbrojtjen e Demokracisë Vendore të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës.

- **PZAP, me ftesë të KQZ-së,** ka marrë pjesë në punëtorinë pas-zgjedhore, të organizuar në bashkëpunim me Komisionin e Venecias, ku qëllimi i kësaj punëtorie ishte shkëmbimi i përvojave dhe diskutimi mbi mësimet e nxëna nga zgjedhjet e mbajtura më 9 shkurt, me fokus në çështjet kyçe si zgjidhja e kontesteve zgjedhore dhe keqpërdorimi i burimeve shtetërore gjatë proceseve zgjedhore.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Në mbështetje të nenit 115 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, PZAP-i, ka dorëzuar në KGJK Raportin Vjetor 2024.

PZAP-i, në mbështetje të nenit 5 paragrafi 5 të Rregullores Nr.12/2024, për Procedurën e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorit të SPZAP-it, ka dorëzuar Raportet gjashtë (6) mujore për periudhat Janar-Qershor dhe Korrik – Dhjetor 2025.

U.D drejtorit të SPZAP-it dhe zyrtarët e SPZAP-it, gjatë vitit 2025 kanë mbajtur takime të ndryshme me përfaqësuesit të KGJK-së, lidhur me bashkëpunimin e aktiviteteve sipas kompetencave të përcaktuara në LZP.

PUNËTORITË E PZAP-it

PZAP-i ka organizuar dhe ka marrë pjesë në punëtori të ndryshme me akterë të procesit zgjedhor, në të cilat kanë marrë pjesë anëtarët e PZAP-it, personeli i sekretariatit të PZAP-it, si dhe përfaqësuesit nga Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe ata të KPM-së.

• Punëtori e organizuar nga PZAP

Sekretariati i PZAP-it, më datë 16 dhe 17 Janar 2025, ka organizuar punëtorinë e parë për trajnimin e stafit të përkohshëm të angazhuar për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës. Temë diskutimi në këtë punëtori ishin: Administrimi i pranimi të ankesave dhe dorëzimi i vendimeve të PZAP-it, Shkeljet e Kodit të Mirësjelljes nga subjektet politike gjatë fushatës zgjedhore, ankesat lidhur me parregullsitë për ditën e votimit, procesi i numërimit të fletëvotimeve në qendrat komunale.



PZAP-i me datat 16 deri me 19 Prill 2025, ka mbajtur punëtori ku tema të diskutimit të kësaj punëtorie ishin: Finalizimi i Raportit Vjetor të punës së PZAP-it për vitin 2024, të gjeturat ligjore nga procesi zgjedhor për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09 Shkurt 2025, si dhe statistikat e ankesave të parashtruara gjatë këtij procesi.



• Punëtori e organizuar nga OSBE

Misioni i OSBE-së, në Kosovë me datën 29 deri me 31 Maj 2025, ka organizuar punëtori, ku tema të diskutimit ishin: prezantimi i Raportit të Bashkimit Evropian Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të 9 Shkurtit, të gjeturat dhe rekomandimet me fokus në kontestet zgjedhore, sipas të cilit PZAP-ja, ka arrit të përmbush mandatin ligjore me profesionalizim, respektimin e afateve të vendimmarrjes, transparencën në proces dhe publikimin e vendimeve në kohë të shkurtër.³

Prezantim i raporteve të vëzhguesve vendor dhe ndërkombëtar (Demokracia në Veprim, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës) Raporti i fundit i Progresit për Kosovën⁴, për zgjedhjet e përgjithshme të 9 shkurtit, Analiza e vendimeve të PZAP-it dhe Aktgjykimeve të Gjykatës Supreme, në lidhje me përdorimin e gjuhës së urrejtjes nga ana e subjekteve politike, gjatë procesit të fundit zgjedhor, plotësim ndryshimi i Rregullores së Procedurave dhe Vendosjen e Ankesave, me të gjeturat ligjore dhe inkorporimi i tyre në këtë rregullore.

³ Bashkimi Evropian Misioni i Vëzhgimit të Zgjedhjeve Kosovë 2025 - Raporti përfundimtar, Zgjedhjet Parlamentare 9 shkurt 2025 https://www.eods.eu/library/EU%20EOM%20Kosovo%202025_Final%20Report_ALB.pdf

⁴ Raporti i fundit i Progresit për Kosovën



- **Punëtori e organizuar nga KPM**

Mbajtur me datën 19 Qershor 2025, e organizuar nga KPM ku tema të diskutimit ishin: Korniza ligjore e aplikueshme gjatë zgjedhjeve në Republikën e Kosovës, përgjegjësitë institucionale të PZAP-it dhe KPM-së gjatë proceseve zgjedhore, trajtimi i rasteve të ankesave, format e bashkëpunimit ndërinstitucional, komunikimi me publikun dhe palët e interesit.

- **Punëtori e organizuar në bashkëpunim të PZAP-së dhe OSBE-së**

Në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë, më 31 Tetor 2025, ka mbajtur punëtorinë një ditore, me temën “Adresimi i sfidave gjatë procesit të zgjedhjeve lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, dhe përgatitjet për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar Komune”.

Gjatë punëtorisë u diskutua për ecurinë e procesit të deritanishëm zgjedhor, sfidat e evidentuara, praktikrat e vendimmarrjes, si dhe u prezantua plani i veprimit për raundin e dytë të zgjedhjeve që do të mbahen më datë 9 nëntor 2025. Gjithashtu u trajtuan çështje që ndërlidhen me buxhetin dhe planifikimin buxhetor të institucionit, në veçanti u potencuan sfidat duke shprehur shqetësimin se Qeveria e Republikës së Kosovës për herë të parë që nga themelimi i PZAP-ës, nuk e ka mbështet me buxhet shtesë për realizimin e mandatit ligjor për procesin e zgjedhjeve Parlamentare të mbajtura me 9 shkurt 2025, për procesin e zgjedhjeve lokale të mbajtura me 12 tetorit 2025, si dhe për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar Komune që do të mbahen me datën 9 nëntor 2025.



PZAP në bashkëpunim me OSBE, mban punëtori lidhur me “Adresimi i sfidave gjatë procesit të zgjedhjeve lokale të mbajtura më 12 tetor 2025”

Me datën 20 deri me 22 Nëntor 2025, e organizuar në bashkëpunim të PZAP-së dhe OSBE-së ku tema të diskutimit ishin: Administrimi i dy proceseve zgjedhore, Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 09.02.2025 dhe Zgjedhjet Lokale 12 Tetor 2025, Përmbledhja e përgjithshme e ankesave në proceset zgjedhore, Trajtimi i ankesave sipas fazave të procesit zgjedhor (para fushatës zgjedhore, fushata zgjedhore, dita e zgjedhjeve, Prezantimi i gjetjeve dhe rekomandimeve nga vëzhguesit e zgjedhjeve, administrimi zgjedhor dhe bashkëpunimi ndër-institucional, zbatimi i buxhetit, sfida dhe planifikimi.

• Punëtori e organizuar nga PZAP

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në kuadër të angazhimeve të tij institucionale dhe aktiviteteve që ndërlidhen me procesin zgjedhor për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025, ka organizuar një punëtori njëditore me qëllim të diskutimit dhe planifikimit të objektivave dhe aktiviteteve të Planit të Punës për vitin 2026.

Gjatë punëtorisë u analizuan aktivitetet kryesore që do të përfshihen në Planin e Punës së PZAP-it për vitin 2026, me fokus të veçantë në analizimin e gjetjeve nga proceset zgjedhore të vitit 2025, si vit zgjedhor, për proceset zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, si dhe për procesin e Zgjedhjeve Lokale, të zhvilluara në dy raunde zgjedhore. Po ashtu, u diskutua për përgatitjen e raportit për të gjitha proceset zgjedhore dhe aktivitetet e PZAP-it për vitin 2025, dhe dërgimin e tij në Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), i cili duhet të bëhet deri në fund të muajit shkurt 2026. Gjithashtu, u trajtuan çështje që lidhen me ri dizajnimin e ueb-faqes së PZAP-it, azhurnimin e bazës së të dhënave për ankesa dhe vendime, si dhe aktivitete të tjera me rëndësi për funksionimin efikas të PZAP-it.



PZAP mban punëtori lidhur me Planin e Punës për vitin 2026

AKTIVITETET E SEKRETARIATIT

Gjatë vitit 2025, Sekretariati i PZAP-it, ka mbajtur e rregullta mujore, të cilat takime i kanë parapri mbajtjes së takimeve të rregullta të Panelit, ku janë shqyrtuar, diskutuar dhe nxjerr vendime në përputhje me LZP-në, si dhe ligjet tjera të aplikueshme. Zyrtarët e Sekretariatit kanë përgatitur të gjitha materialet e nevojshme për mbajtjen e takimeve të PZAP-it, si draft agjendat e takimeve, procesverbalet e takimeve/mbledhjeve të kaluara të PZAP-it, përgatitjen e vendimeve për aprovim në takimet e mbajtur nga PZAP.

Në kuadër të hartimit të dokumenteve ligjore dhe strategjike, gjatë kësaj periudhe raportuese, zyrtarët e Sekretariatit, gjegjësisht zyrtarët nga Departamenti Ligjor kanë përgatitur Draft Planin e Punës së PZAP-it për vitin 2026, është përgatitur dhe finalizuar Rregullorja Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Raporti vjetor i punës së PZAP-it, për vitin 2024, Plani i Veprimit/Aktivitetet Kryesore të PZAP-it për Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës për zgjedhjet e 09 shkurtit 2025, për Zgjedhjet Lokale 12 Tetor 2025 dhe për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 28 dhjetor 2025.

Gjithashtu gjatë këtij viti është përgatitur dhe dorëzuar në KGJK edhe Raporti gjashtë mujor i punës së PZAP-it për periudhën Janar-Qershor 2025, Raporti gjashtë mujor Korrik – Dhjetor 2025, përgatitja e pjesës së historikut të PZAP-it, sipas kërkesës së KGJK-së. Sa i përket proceseve zgjedhore janë kryer një mori aktivitete: Planet e veprimit, njoftimi i KQZ-së, në lidhje me gjobat e papaguara të subjekteve politike, njoftimi për personat të cilëve me vendimet e PZAP-it, ju është ndaluar e drejta për pjesëmarrja në zgjedhje si kandidat apo si anëtar të Trupave Menaxhuese të Zgjedhjeve të organizuara nga KQZ, etj.

Në përputhje me mandatin e tij U.D Drejtori i Sekretariatit të PZAP-it, ka marrë vendime për të gjitha çështjet administrative që ndërlidhën me funksionimin e PZAP-it, në kuadër të aktiviteteve të kryera dhe dokumenteve të përgatitura nga zyrtarët e Departamentit Ligjor dhe Departamentit për Financa dhe Shërbime të përgjithshme, në nivel të përgjegjësisë janë nxjerr vendime dhe shkresa tjera nga sekretariati, ndërsa të tjerat janë dërguar për miratim në Panelin e PZAP-it.

- Vendim për emërimin e Komisionit të Pranimi për vlerësimin profesional të kandidatëve;
- Vendimet për emërimin e U.D Drejtorit të Departamentit Ligjor;
- Vendimi për zgjatjen e orarit të punës dhe kompensimit e orëve të punës për zyrtarët e Sekretariatit për secilin proces zgjedhore të mbajtura në vitin 2025;
- Vendime për caktimin e Menaxhereve të kontratave të AQP-së;
- Vendim për transferimin e përhershëm të nëpunësës,
- Vendim për plotësim ndryshimin e vendimit për harmonizimin e titullit të vendit të punës,
- Vendim për konfirmimin e marrëdhënies së punës,
- Vendim për formimin e komisionit për vlerësim të ofertave;
- Vendim për formimin e komisionit të përzgjedhjes për vlerësimin profesional të kandidatëve me kontratë për periudhë të caktuar,
- Vendimet për formimin e Komisioneve për inventarizimin e pasurisë jo financiare, për tjetërsimin e pasurisë jo financiare, si dhe për vlerësimin e pasurisë jo financiare,
- Përgatitjen e paneleve të PZAP-it, duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion gjatë procesit zgjedhor,
- Përgatitja dhe dorëzimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH-it) në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve për vitet 2026-2028;
- Përgatitja dhe dorëzimi i kërkesave të para buxhetore për vitin 2026 dhe vlerësimet për vitet 2027-2028 dhe futja e këtyre kërkesave në sistemin e BDMS-s, kërkesa e cila është dërguar në MFPT dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- Përgatitja e kërkesës për buxhet shtesë më datën 15.01.2025, për procesin zgjedhor të Zgjedhjeve të Rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09 shkurt 2025 si dhe për Zgjedhjet Lokale që janë mbajtur më 12 tetor 2025;
- Përgatitja e kërkesës për buxhet shtesë më datën 11.06.2025, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 Tetor 2025;
- Përgatitja dhe dorëzimi i Pasqyrave Financiare të PZAP-it, për vitin 2025, në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve etj;
- Përgatitja dhe dorëzimi në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve të Raportit vjetor për sistemin e kontrollit të brendshëm për vitin 2025;
- Përgatitja e dokumentacionit për harmonizime (transfere) të brendshme buxhetore në mes kategorive ekonomike;
- Përgatitja e Raportit gjashtëmujor të Sekretariatit të PZAP-it për periudhën janar–qershor 2025 dhe dërgimi i tij në Këshillin Gjyqësor të Kosovës;
- Zbatimi i rekomandimeve të dala nga raporti përfundimtar i Bashkimit Evropian lidhur me procesin zgjedhor të 9 shkurtit 2025;
- Përgatitja e historikut të PZAP-it ndër vite, zhvillimi i tij institucional, ndryshimet ligjore, kompetencat dhe mekanizmat e llogaridhënies, deri në kalimin e tij në kuadër të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Në zbatim të Rregullores së KGJK-së Nr. 12/2025 për strukturën organizative dhe klasifikimin e pozitave të Sekretariatit të PZAP-it, janë nxjerrja akt emërimet e reja për të stafin e Sekretariatit të PZAP-së.



Mbajtja e takimeve të Sekretariatit të PZAP-it

Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe ngritja e kapaciteteve

- Zhvillimi dhe përfundimi i procedurave për rekrutimin e kandidatëve për pozitat Zyrtar për Transport dhe Zyrtar për Teknologjinë e Informative;
- Zhvillimi i procedurave të rekrutimit për 10 pozita, Zyrtar të Përkohshëm për procesin zgjedhor të Zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 për Kuvend të Republikës së Kosovës, dhe i shtatë (7) zyrtarëve të përkohshëm për Zgjedhjet Lokale të vitit 2025;
- Përgatitja e formularëve dhe shkresave tjera për pagesën e stafit të PZAP-it, për orë shtesë, kërkesa retroaktive, formular me të dhëna për punëtorë të rinj, për anëtarë të PZAP-it dhe stafin e rekrutuar, dhe dorëzimi i tyre në Thesar-MFPT;
- Është bërë menaxhimi i të gjitha sistemeve si dhe përditësimi i të dhënave të nevojshme që lidhen direkt me përgjegjësitë e zyrës së personelit, si sistemi për menaxhimin e Burimeve Njerëzore HRMIS sistemi i Hyrje -Daljeve SMVP, sistemin i Menaxhimit të Pagave, SMP;
- Bashkëpunim me ASHI, për hapje të llogarisë zyrtare,
- Bashkëpunim me KPMSHCK lidhur me ankesat për procedura të rekrutimit, Bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë lidhur me mbajtjen e trajnimeve për zyrtarë të SPZAP-it, si dhe bashkëpunim me KGJK rreth implementimit të Planit për Trajnime;

Trajnimet e Zyrtarëve të Sekretariatit

Personeli i Sekretariatit të PZAP-it, gjatë periudhës Janar-Qershor 2025, ka marrë pjesë në trajnimet e organizuara nga Akademia e Drejtësisë:

- Trajnim lidhur me teknikat e hartimit të raporteve,
- Shkathësitë ligjore dhe gjyqësore,
- Dorëzimi i shkresave gjyqësore,

- Trajnim i trajnuesve sipas metodologjisë së përcaktuar në Doracakun për Trajnues të Akademisë së Drejtësisë,
- Trajnim i organizuar nga IKAP- AIP me temën: Mbrojtja e të dhënave personale.
- Trajnim i organizuar nga AIP financuar nga ambasada e Holandës në Kosovë, me temën: Baza e mbrojtjes së të dhënave personale.

Aktivitetet e kryera të prokurimit publik

- Përgatitja, dërgimi dhe publikimi në Sistemin e E-Prokurimit të Planit përfundimtar të Prokurimit Publik për vitin 2025;
- Zbatimi i kontratave të lidhura nga AQP, që shfrytëzohen nga PZAP;
- Zhvillimi i aktivitetit të prokurimit për lidhjen e kontratës për sigurimin, servisimin dhe blerjen e gomave për automjetet e PZAP-ës, dhe furnizimi me material zyrtar.

Aktivitetet lidhur me shpenzimet financiare të certifikuara

Certifikimi i shpenzimeve të realizuara për të gjitha kontratat e lidhura me operatorët ekonomik si: (shpenzimet e telefonisë fiks edhe mobile, TV kabllor, internet dhe fotokopje, për ujë të pijshëm, pastrimin e veturave e karburante, udhëtimet zyrtare dhe të angazhimit e stafit jo permanent për proceset zgjedhore për vitin 2025.

BUXHETI DHE FINANCAT

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa financohet nga Buxheti i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës dhe, në këtë cilësi, mjetet financiare menaxhohen dhe shpenzohen me nivel të lartë përgjegjësie, transparence dhe llogaridhënieje.

Ky raport është hartuar në përputhje me Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), si dhe me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), duke u bazuar në parimin e kontabilitetit në bazë të parasë së gatshme. Politikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme dhe të pandërprerë gjatë gjithë periudhës raportuese, duke siguruar krahasueshmëri dhe saktësi të të dhënave financiare.

Burim për përgatitjen e këtij raporti kanë shërbyer raportet e gjeneruara nga Sistemi i Menaxhimit të Financave të Kosovës (SIMFK), si dhe dokumentacioni financiar përkatës, përfshirë librat financiarë, faturat, raportet e pranimit të mallrave, kontratat dhe dokumente të tjera relevante të institucionit.

Të gjitha pagesat janë realizuar përmes Sistemit të Menaxhimit të Financave Publike të Kosovës (SIMFK – Free Balance), në përputhje me procedurat ligjore dhe rregulloret në fuqi.

Në bazë të Ligjit nr. 08/L-332 për Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës për vitin fiskal 2025, Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa i është ndarë buxhet fillestar në vlerë prej 262,421 euro. Gjatë vitit fiskal janë realizuar ndryshime buxhetore, si rezultat i të cilave buxheti përfundimtar në fund të vitit ka arritur në shumën prej 231,703 euro.

Planifikimi i buxhetit është bërë në nivel të kategorive ekonomike, përkatësisht sipas zërave buxhetorë, duke respektuar legjislacionin financiar në fuqi, Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, si dhe strukturën ekzistuese të planit kontabël. Brenda këtij kuadri, planifikimi është realizuar sipas kategorive ekonomike si në vijim:

Në kuadër të këtij buxheti, planifikimi është realizuar sipas kategorive ekonomike si në vijim:

Buxheti i aprovuar dhe i ndryshuar gjatë vitin 2025

Përshkrimi	Buxheti i aprovuar fillestar	Buxheti i ndryshuar me vendim te Qeveris	Buxheti i ndryshuar me transfer	Buxheti i ndryshuar me kursime dhe ndarje buxhetore sipas vendimit te	Buxheti i ndryshuar me vendimit te Qeveris në fund të vitit	Buxheti ne fund te vitit
Paga dhe shtesa	201,601	7,077	(10,000)		(37,795)	160,883
Mallra dhe shërbime	53,000	-	10,000	7,000		70,000
Shpenzime Komunale	7,820	-		(7,000)		820
Total:	262,421	7,077	0	0	0	231,703

Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të ndërmarra gjatë vitit 2024 në kuadër të proceseve buxhetore, përfshirë hartimin e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2025–2027, si dhe adresimin e kërkesave përmes Qarkoreve Buxhetore nr. 2025-01 dhe nr. 2025/02, me të cilat është kërkuar ndarja e mjeteve shtesë për vitin 2025, këto kërkesa nuk janë reflektuar në buxhetin përfundimtar të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa. Kërkesat për buxhet shtesë kanë qenë të bazuara në nevojat reale institucionale, duke pasur parasysh se gjatë vitit 2025 janë zhvilluar dy procese të rregullta zgjedhore, të cilat kanë rritur ndjeshëm vëllimin e punës dhe përgjegjësitë e institucionit. Megjithatë, pavarësisht arsytimit dhe argumentimit të paraqitur, këto kërkesa nuk janë përfshirë në buxhetin e miratuar për vitin 2025.

Prandaj pas funksionalizimit të buxhetit për vitin 2025, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa ka bërë analizën e detajuar të buxhetit të aprovuar me Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës nr. 08/L-332 për vitin 2025. Nga kjo gjendje është konstatuar se buxheti i ndarë nuk i përmbush nevojat dhe obligimet e PZAP-së për këtë vit, për shkak të mbajtjes së dy proceseve të rregullta zgjedhore, dhe atë:

- Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09 shkurt 2025;
- Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më 12 tetor 2025.

Këto dy procese zgjedhore kanë paraqitur sfidë të vazhdueshme për PZAP-në gjatë gjithë vitit, duke ndikuar drejtpërdrejt në kapacitetet buxhetore dhe operative të institucionit. Si rrjedhojë, PZAP është detyruar të ndërmarrë masa të kursimit dhe rishpërndarjes së brendshme të fondeve, për të siguruar funksionimin e pandërprerë institucional dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore.

Masat e ndërmarra për menaxhimin e buxhetit

Për shkak të kufizimeve buxhetore, PZAP ka ndërmarrë këto masa:

- Reduktim të numrit të stafit mbështetës të angazhuar për proceset zgjedhore;
- Shtyrje ose anulim të disa punëtorëve që kishin për qëllim diskutimin dhe përmirësimin e proceseve zgjedhore;
- Kujdes maksimal dhe prioritet në shpenzimin e mjeteve për aktivitetet e përditshme institucionale.

Në përpjekje për të siguruar fonde shtesë për mbulimin e shpenzimeve zgjedhore, PZAP i është drejtuar Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) me kërkesa zyrtare si vijon:

- Më 15.01.2025, PZAP ka kërkuar mbështetje buxhetore shtesë në shumë prej 134,128 €, për procesin zgjedhor të Zgjedhjeve të Rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09 shkurt 2025 si dhe për Zgjedhjet Lokale që janë mbajtur më 12 tetor 2025.
 - Kjo kërkesë nuk është aprovuar nga MFPT, dhe shpenzimet janë mbuluar nga buxheti i rregullt i PZAP-së.
- Më 11.06.2025, PZAP ka përsëritur kërkesën për buxhet shtesë në shumë prej 39,500 €, për mbulimin e shpenzimeve të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025.
 - Edhe kjo kërkesë nuk është aprovuar nga MFPT.

Në muajin shtator 2025, pas një analize të hollësishme të gjendjes financiare, kemi shfrytëzuar mundësinë ligjore për transferim të mjeteve buxhetore nga kategoria e pagave dhe shtesave në kategorinë mallra dhe shërbime, në shumë prej 10,000 €. Gjithashtu, pas shpalljes së Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të cilat u mbajtën më 28 dhjetor 2025, kemi shfrytëzuar mundësinë për të kërkuar që, në kuadër të përmbylljes së vitit fiskal, MFPT të ushtrojë kompetencat e saj për realizimin e kursimeve dhe rialokimeve buxhetore. Në këtë drejtim, kemi paraqitur kërkesën që shuma prej 7,000 € nga kategoria e shpenzimeve komunale të ri-destinohet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.


Po ashtu në fund të vitit sipas vendimit nr.01/281 të datës 24.12.2025 në kategorinë paga dhe shtesa PZAP-së i është shkurtuar buxheti në shumë prej 37,795€.

Këto mjete janë përdorur kryesisht për pagesën e zyrtarëve të përkohshëm të angazhuar gjatë procesit zgjedhor. Pavarësisht sfidave të mëdha financiare gjatë vitit 2025, PZAP ka arritur të menaxhojë me kujdes buxhetin e aprovuar dhe të sigurojë realizimin e obligimeve të veta ligjore në lidhje me proceset zgjedhore.

Duke analizuar buxhetin e PZAP-it në fund të vitit, në vlerë prej 231,703€ si dhe strukturën buxhetore rezulton se prej tyre :

- 67 %, e fondeve janë akorduar për mbulimin e shpenzimeve për paga dhe shtesa,
- 30 %, e fondeve është akorduar për shpenzime, mallra dhe shërbime,
- 3 %, për shpenzimet komunale,

STRUKTURA E BUXHETIT PËR VITIN 2025



SHPENZIMET

Pas miratimit të buxhetit për vitin 2025 dhe në përputhje me planin operacional të aprovuar, PZAP ka realizuar menaxhimin e fondeve të akorduara në mënyrë të rregullt, transparente dhe në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi. Shpenzimi i buxhetit është kryer sipas zërave të planifikuar buxhetorë, duke respektuar parimet e përgjegjshmërisë financiare, efikasitetit dhe ekonomicitetit.

Fondet e miratuara janë shfrytëzuar në mënyrë efektive, duke mundësuar realizimin e aktiviteteve të planifikuara brenda afateve të përcaktuara dhe në përputhje me objektivat programore të institucionit. Gjatë gjithë vitit është treguar kujdes i veçantë për administrim të përgjegjshëm financiar dhe përdorim racional të mjeteve buxhetore, me theks në transparencë dhe llogaridhënie.


Duke qenë se viti 2025 ishte vit zgjedhor, gjatë tij janë organizuar tri procese zgjedhore, përkatësisht:

- Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09 shkurt 2025;
- Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më 12 tetor 2025, përfshirë edhe procesin e balotazhit;
- Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025.

Për financimin e aktiviteteve të zhvilluara gjatë vitit 2025, PZAP ka shpenzuar gjithsej 227,158 €, që përfaqëson 98% të buxhetit final të miratuar. Ky nivel i realizimit dëshmon për planifikim të kujdesshëm dhe menaxhim efikas të burimeve financiare, duke siguruar mbështetje të plotë për përmbushjen e mandatit dhe përgjegjësisë ligjore të institucionit gjatë një viti me intensitet të lartë aktiviteteve zgjedhore.

Nr	Përshkrimi	Buxheti	Shpenzuar	Shpenzuar në (%)	Mbetur
1	Paga dhe shtesa	160,883 €	160,883 €	100%	0 €
2	Mallra & shërbime	70,000 €	65,990 €	94%	4,010 €
3	Shpenzime komunale	820 €	284 €	34%	536 €
Gjithsej		231,703 €	227,157 €	98%	4,546 €

Krahasimi në mes të Planifikimit dhe Shpenzimit të Buxhetit



Paga dhe shtesa


Buxheti i alokuar pas ndryshimeve buxhetore gjatë vitit për paga dhe shtesa për vitin 2025 ka qenë në vlerë prej 160,883 €. Gjatë periudhës raportuese, ky buxhet është shpenzuar në tërësi, përkatësisht 160,883 €, që përfaqëson 100% të buxhetit final të miratuar për këtë kategori.

Numri i aprovuar i të punësuarve për vitin 2025 ka qenë 21, ndërsa gjatë vitit numri aktual i të punësuarve ka qenë 19. Menaxhimi i fondeve për paga dhe shtesa është realizuar në përputhje me kornizën ligjore në fuqi për pagat, duke siguruar funksionimin e rregullt të institucionit dhe përmbushjen e detyrave gjatë një viti, përkundër ngarkesës së shtuar për shkak të proceseve zgjedhore e mbajtura në vitin 2025.

Shpenzimi i mjeteve për paga dhe shtesa për vitin 2025 sipas nënkategorive ekonomike

Nr	Kategorizimi i shpenzimeve sipas listës së pagave	Shpenzimi
1	Pagat neto përmes listës së pagave	116,927.81
2	Tatimi i ndalur në të ardhura personale	11,540.00
3	Kontributi pensional i punëtorit	7,661.11
4	Përvoja e punës	5,405.67
5	Kontributi pensional i punëdhënësit	7,661.11
6	Puna jashtë orarit të rregullt	11,687.17
Gjithsej		160,883

SHPENZIMI PAGA DHE SHTESA 2025



Mallra dhe shërbime


Buxheti i alokuar pas ndryshimeve buxhetore gjatë vitit për mallra dhe shërbime për vitin 2025 ka qenë në vlerë prej 70,000€. Gjatë periudhës raportuese, ky buxhet është shpenzuar në shumë prej 65,990€ apo 94% që përfaqëson 94% të buxhetit final të miratuar për këtë kategori.

Shpenzimi i mjeteve në mallra dhe shërbime për vitin 2025 sipas nënkategorive ekonomike

Nr	Kategorizimi sipas nënkategorive - mallra dhe shërbime	Shpenzimi
1	Mëditjet për udhëtime zyrtare brenda vendit	864
2	Mëditjet për udhëtime zyrtare jashtë vendit	2662.8
3	Akomodimi udhëtime zyrtare jashtë vendit	2160
4	Shpenzime tjera udhëtime zyrtare jashtë vendit	101
5	Interneti	557.88
6	Telefonia mobile	6700
7	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	2450
8	Furnizime për zyre	2151,64
9	Furnizim me ushqim dhe pije – jo dreka zyrtare	641.3
10	Derivate për vetura zyrtare	1745.66
11	Sigurimi i automjeteve	1264
12	Shërbimet kontraktuese tjera	36,082
13	Qiraja për pajisje	1,582
14	Kompensim i përfaqësimit brenda vendit	6,807
15	Pajisje trafiku	50
16	Regjistrimi i automjeteve	150

17	Taksa komunale për automjete	20
Gjithsej		65,990

SHPENZIMI MALLRA DHE SHËRBIME 2025



Shpenzimet komunale

Buxheti për kategorinë shpenzime komunale për vitin 2025, është 820€. u shpenzuan 284€ apo 34% e buxhetit krahasuar me buxhetin në fund të vitit.

Shpenzimet komunale	Shpenzimi
Shpenzimet e telefonisë fikse	284
Gjithsej	284

TË HYRAT

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar tri procese zgjedhore, për të cilat janë shqiptuar gjoba në vlerë të përgjithshme prej 937,800 €. Këto gjoba lidhen me shkeljet e konstatuara gjatë zhvillimit të proceseve zgjedhore dhe janë shpërndarë sipas proceseve si më poshtë.


Nr	Procesi zgjedhor	Gjobat e shqiptuara për tri proceset zgjedhore 2025	Realizimi i gjobave gjatë vitit 2025	Mbetja e borxhit
1	Zgjedhjet e Rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 09 - shkurt 2025	651,100	642,900	8,200
2	Zgjedhjet Lokale - 12 tetor 2025	124,700	119,400	5,300
3	Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës - 28 dhjetor-2025	162,000		162,000
Total		937,800	762,300	175,500

Procesi zgjedhor me peshën më të madhe financiare për sa i përket gjobave të shqiptuara ka qenë Zgjedhjet e Rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 09 shkurt 2025, me gjithsej 651,100 €, që përbëjnë 70% të totalit të gjobave të shqiptuara për vitin 2025. Gjatë këtij procesi, realizimi i gjobave ka arritur në 642,900 €, ndërsa mbetja e borxhit është 8,200 €.

Në Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, janë shqiptuar gjoba në vlerë prej 124,700 €, që përfaqësojnë 13% të totalit vjetor. Nga kjo shumë, gjatë vitit 2025 janë realizuar 119,400 €, ndërsa mbetja e borxhit arrin në 5,300 €.

Ndërkaq, në kuadër të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 28 dhjetor 2025, janë shqiptuar gjoba në vlerë prej 162,000 €, që përbëjnë 17% të totalit të gjobave. Për këtë proces zgjedhor, realizimi i gjobave nuk është evidentuar gjatë vitit raportues, duke rezultuar me mbetje të plotë të borxhit në vlerën prej 162,000 €.

Në total, gjatë vitit 2025 është realizuar inkasimi i gjobave në vlerë prej 762,300 €, ndërsa mbetja e përgjithshme e borxhit nga gjobat e shqiptuara për tri proceset zgjedhore është 175,500 €.



Pjesëmarrja në % e gjobave për tri proceset zgjedhore 2025

Nr	Procesi zgjedhor	Gjohat e shqiptuara për tri proceset zgjedhore 2025	Pjesëmarrja në %
1	Zgjedhjet e Rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 09 - shkurt 2025	651,100	70%
2	Zgjedhjet Lokale - 12 tetor 2025	124,700	13%
3	Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës - 28 dhjetor-2025	162,000	17%
Total		937,800	

Rekomandimet e auditimit të pasqyrave financiare të PZAP-it për vitin 2024

Sipas konkluzionit të ZKA-së, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të PZAP-së, kanë qenë në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar – PZAP-in në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Rekomandimi i ZKA-së në raportin e pasqyrave financiare të PZAP-it, të vitit 2024, i cili është zbatuar gjatë vitit 2025 janë:

- Sekretariati i PZAP-së duhet të forcoj kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive në mënyrë që të siguroj regjistra të plotë, të saktë dhe klasifikimin e tyre sipas klasifikimit kontabël si dhe prezantim të drejt në Pasqyra Financiare Vjetore. Shkaku i kësaj situate ishte mungesa e zyrtarit të pasurisë, situate e cila ka sjell në dështimin për të identifikuar dhe korrigjuar këto mangësi në kohë.

Ky rekomandim i dhënë nga ZKA, dhe është zbatuar nga PZAP-i.

Është bërë menaxhimi dhe organizimi i detyrave teknike brenda njësisë së TI, duke ofruar përkrahjen e nevojshme për funksionalizimin sa më të mirë të pajisjeve të Teknologjisë Informative brenda PZAP-së.

SHËRBIMET E PËRGJITHSHME

Në kuadër të Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme janë zhvilluar aktivitete nga fusha e logjistikës, teknologjisë informative, përkthimeve dhe transportit, të cilat gjatë vitit raportues kanë siguruar mbështetje të vazhdueshme administrative dhe teknike për funksionimin efikas dhe të pandërprerë të PZAP-së.

Më poshtë paraqiten aktivitetet kryesore të realizuara gjatë vitit raportues:

Teknologjia Informative dhe Sistemet

- Është bërë koordinimi, menaxhimi dhe organizimi i detyrave teknike brenda Njesisë së TI-së, me qëllim sigurimin e funksionimit të qëndrueshëm dhe efikas të pajisjeve të Teknologjisë Informative në PZAP.
- Është realizuar planifikimi, administrimi, menaxhimi dhe mirëmbajtja e teknologjisë informative dhe aplikacioneve të Microsoft-it të ofruara nga Ministria e Punëve të Brendshme.
- Është administruar ueb faqja zyrtare e PZAP-it dhe Sistemi për Menaxhimin e Ankesave (SMA).
- Është bërë montimi, instalimi dhe konfigurimi i kompjuterëve për panelin dhe stafin jo permanent, si dhe regjistrimi i tyre në domenin e PZAP-së.
- Është siguruar mirëmbajtja dhe azhurnimi i vazhdueshëm i ueb faqes zyrtare dhe i rrjeteve sociale të PZAP-it.
- Janë regjistruar të gjitha ankesat në Sistemin për Menaxhimin e Ankesave (SMA) dhe janë publikuar vendimet në gjuhën shqipe dhe serbe në faqen zyrtare.
- Është menaxhuar llogaria zyrtare e email-it të PZAP-së, duke siguruar pranimin dhe dërgimin me kohë të email-eve si dhe funksionalitetin e sistemit për zyrtarët.
- Është konfiguruar dhe aktivizuar procesi automatik i backup-it javor në sistemin Synology NAS, me qëllim garantimin e ruajtjes dhe rikuperimit të të dhënave.

Menaxhimi i Inventarit dhe Pasurisë

- Është realizuar regjistrimi dhe azhurnimi i inventarit në sistemet E-Pasuria dhe SIMFK.
- Është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i pasurisë në përputhje me vendimet e komisioneve përkatëse, si dhe janë dhënë rekomandime për komisionin për tjetërsim të pasurisë kur është vlerësuar e nevojshme.
- Është kryer kontrolli i hyrje-daljeve të materialit shpenzues dhe pajisjeve të IT-së dhe regjistrimi i tyre në sistemin e-Pasuria.
- Janë përpiluar raporte lidhur me ngarkimin dhe shkarkimin e pajisjeve të punës për të punësuarit e PZAP-së.
- Përkthime dhe Mbështetje Administrative
- Janë përkthyer dokumentet e nevojshme nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas, sipas kërkesave të Panelit dhe zyrtarëve të Sekretariatit të PZAP-it.

Menaxhimi i Automjeteve

PZAP-i ka në pronësi dy automjete zyrtare, të cilat shfrytëzohen për kryerjen e aktiviteteve zyrtare të institucionit:

- Mitsubishi Outlander, me targa të regjistrimit 5Z-101-17;
- Ford Focus, me targa të regjistrimit 5Z-102-17.
- Pasqyrimi i shpenzimeve për KM dhe Karburante për vitin 2025

Nr	Automjeti	Kilometrat e kaluara për vitin 2025	Litrat e shpenzuara për vitin 2025
1	Mitcubish 5Z -101-17	11250	1009
2	Ford Fokus 5Z-102-17	6740	485
3	Veturat e huazuara nga KGJK (dy vetura)	1461	120
Total:		19451	1614

Me qëllim të realizimit / përmbushjes së aktiviteteve PZAP-i, ka organizuar një punëtori jashtë vendit, dhe për shkak se PZAP nuk ka pas në dispozicion automjete të mjaftueshme për organizmin dhe përkrahjen logjistike të kësaj punëtorie ka huazuar dy (2) automjete te nevojshme nga KGJK, ku shpenzimet e derivateve janë mbuluar nga PZAP-i.

Është mbajtur evidenca e automjeteve të PZAP-së dhe janë ofruar shërbime sipas kërkesave.

Është realizuar regjistrimi, mirëmbajtja dhe servisi i rregullt i automjeteve, si dhe janë përpiluar raporte të veçanta për shpenzimet e derivateve.

AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE PËR PROCESIN ZGJEDHORE 2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në kuadër të Zgjedhjeve të Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09 Shkurt 2025, Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 12 Tetor 2025, Zgjedhjet për Raundin e dytë për Kryetar të Komunës të datës 09 Nëntor 2025, si dhe Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, ka ndërmarrë të gjitha përgatitjet e nevojshme në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, me qëllim të garantimit të një procesi efikas të pranimit, shqyrtimit dhe vendimmarrjes mbi ankesat eventuale që mund të paraqiten gjatë këtij procesi zgjedhor.

Ashtu si në çdo cikël zgjedhor, edhe për proceset zgjedhore të vitit 2025, PZAP-i ka vepruar në bazë të mandatit të tij të përcaktuar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) dhe Rregullat Zgjedhore, duke u mbështetur gjithashtu në vendimin e Presidentes për shpalljen e zgjedhjeve, në praktikën e mira të proceseve zgjedhore të mëparshme, si dhe duke marrë për bazë edhe Planin Operacional të KQZ-së për Zgjedhjet e Përgjithshme, për Kuvend të Republikës së Kosovës, Zgjedhjet Lokale dhe Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, i cili përcakton afatet kohore për realizimin e aktiviteteve zgjedhore nga ana e KQZ-së.

Në përputhje me këto dokumente dhe koordinime, PZAP-i ka hartuar Planin e Veprimit të institucionit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura më 09 shkurt 2025⁵, Planin e Veprimit për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 Tetor 2025⁶, Planin e Veprimit për Raundin e dytë për Kryetar të Komunës për Zgjedhjet lokale të datës 09 Nëntor 2025⁷, Planin e Veprimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura më 28 Dhjetor 2025⁸, në të cilat janë të përcaktuara afatet dhe veprimet konkrete që lidhen me kompetencat dhe detyrat e tij. Kjo pasi që vendimet dhe afatet e

përcaktuara nga KQZ-ja, kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në realizimin e aktiviteteve operacionale të PZAP-it.

Në Planet e veprimit të PZAP-it, për proceset zgjedhore të vitit 2025, janë paraqitur aktivitetet që kanë të bëjnë më ankesat eventuale lidhur me:

- Nominimin dhe emërimin e anëtarëve të Komisioneve Komunale të zgjedhjeve ;
- Aplikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje;
- Certifikimin e subjekteve politike dhe kandidatëve për pjesëmarrje në zgjedhje,;
- Tërheqjen e kandidatëve nga shorti i fletëvotimit dhe afati i zëvendësimit të kandidatëve;
- Aplikimin për regjistrim si votues jashtë Kosovës;
- Aplikimin për regjistrim si votues me nevoja të veçanta;
- Periudhën e Votimit Jashtë Kosovës;
- Certifikimin e Listës së Votuesve;
- Nominimin dhe emërimin e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve;
- Periudhën e fushatës së zgjedhjeve për subjektet politike;
- Aplikimin për akreditim të vëzhguesve;
- Për thyerjen e heshtjes zgjedhore, në ditën e votimit;
- Parregullsitë/shkeljet për ditën e votimit;
- Pranimin e ankesave nga Qendra e Numërimit të Rezultateve/ QNR;
- Me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve nga KQZ-ja;
- Shkresën konfirmuese të PZAP-it, për KQZ-në, për të Certifikuar Rezultatet e Zgjedhjeve.

⁵ Plan i Veprimit për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Republikës së Kosovës 09 Shkurt 2025
<https://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/11/Plani-i-Veprimit-per-Zgjedhjet-Parlamentare-2025.pdf>

⁶ Plan i Veprimit për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025
<https://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/11/Plani-i-Veprimit-per-Zgjedhjet-Lokale-te-dates-12-Tetor-2025.pdf>

⁷ Plan i Veprimit Raundi i dytë për Kryetar të Komunës për Zgjedhjet Lokale të datës 09 Nëntor 2025
<https://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/11/Plani-i-Veprimit-Raundi-i-dyte-balotazhi-per-Zgjedhjet-Lokale-te-dates-09-Nentor-2025.pdf>

⁸ Plan i Veprimit për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 28 Dhjetor 2025:
<https://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/12/Plani-i-Veprimit-i-PZAP-it-per-Zgjedhjet-Parlamentare-te-dates-28-Djetor-2025-1.pdf>

BASHKËPUNIMI I PZAP-IT, ME AKTERËT E TJERË TË ZGJEDHJEVE

Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit dhe koordinimit të vazhdueshëm institucional nënshkruar në vitin 2020⁹, në mes të akterëve të zgjedhjeve, PZAP-it, KQZ-së, Prokurorisë së Shtetit, Policisë së Kosovës, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Komisioni i Pavarur për Media, PZAP, ka implementuar të gjitha obligimet e parapara me këtë Memorandum.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në mes të akterëve të zgjedhjeve nënshkruese të Memorandumit është mbajtur takimi i organizuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me koordinimin e aktiviteteve të gjitha institucioneve për zgjedhjet e shpallura, Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvend të Kosovës të caktuara me datë 09 Shkurt 2025, Zgjedhjet Lokale të caktuara më datë 12 Tetor 2025 dhe Zgjedhjet e Parakohshme të caktuara më datë 28.12.2025.

Përveç këtij takimi dhe aktiviteteve në mes të PZAP-it, dhe KQZ-së, ka pasur shkëmbim të informatave lidhur me ankesat e PZAP-it, të para fushatës zgjedhore për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 09.02.2025, Zgjedhjet Lokale 12 Tetor 2025 dhe Zgjedhjet e Parakohshme 28.12.2025, si dhe verifikim të nominimeve të anëtarëve të këshillave vendvotimeve dhe anëtar të komisioneve komunale të zgjedhjeve për këto procese zgjedhore.

Kërkesat për Qasje në dokumente publike

PZAP-i, më datë 29 Janar 2025, ka përgatitur dhe dorëzuar Raportin për Qasje në Dokumente Publike për vitin 2024, sipas kërkesës së Agjencisë për Informim dhe Privatësi. PZAP-i, gjatë vitit 2025, ka pranuar 255 kërkesa përmes emaili nga gazetarë, OJQ, Ambasada, të cilët kanë kërkuar, informata, raporte dhe të dhëna statistikore, lidhur me ankesat dhe vendimet për proceset Zgjedhore të Zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës 09.02.2025, Zgjedhjeve Lokale 12 Tetor 2025 dhe Zgjedhjet e Parakohshme të Kosovës 28.12.2025. Nga këto 255 kërkesa përmes emaili, tri kanë pasur të bëjnë me Qasjen në Dokumente Publike, 120 janë paraqitur nga mediumet, 121 janë paraqitur nga individë (votues jashtë Kosove, nëntë emaille nga organizatat OJQ (Kallxo.com, Betimi për Drejtësi, KDI), dhe dy kërkesa janë paraqitur për raport lidhur me zgjedhjet nga Ambasada e Austrisë dhe nga Bashkimi Evropian. Lidhur me këto kërkesa, PZAP-i, iu është përgjigjur dhe ofruar informata sipas kërkesave të tyre brenda afateve të parapara në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

⁹ Memorandum i Bashkëpunimit – PZAP, KQZ, PK, PSH, KGJK, KPM <https://pzap.rks-gov.net/wp-content/uploads/2024/03/Memorandum-bashkepunimi-2020-PZAP-KQZ-PK-PSH-KGJK-KPM.pdf>

02. PJESA E DYTË

ZHVILLIMI I PROCESIT TË ZGJEDHJEVE TË PËRGJITHSHME PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS TË MBAJTURA MË 9 SHKURT 2025

Nga shpallja e Zgjedhjeve të Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, me dekretin e Presidentes me Nr. Protokolli 119/2024, të datës 16.08.2024, të mbajtura më 9 shkurt 2025, e deri më 27 mars 2025, respektivisht deri në përfundimin e afatit për paraqitjen e ankesave kundër vendimit të KQZ-së, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve – në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) janë paraqitur gjithsej 642 ankesa, të cilat janë shqyrtuar dhe vendosur brenda afateve të përcaktuara me ligj. Ankesat e paraqitura kanë përfshirë të gjitha fazat e procesit zgjedhor, përkatësisht: periudhën para fushatës zgjedhore, fushatën zgjedhore, ditën e votimit, procesin e administrimit të numërimit në Qendrat e Numërimit (QKN) dhe Qendrën për Numërimin dhe Rezultatet (QNR), si dhe ankesat lidhur me rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të shpallura nga KQZ-ja.

Në tabelën e mëposhtme janë të pasqyruara ankesat e regjistruara në web faqen e PZAP-it, duke përfshirë ankesën, natyrën e shkeljes dhe vendimmarrjen e PZAP-së, në kohë reale.

Numri i rastit/ Case number	Data e pranimit / Receipt Date	Lloji i rastit / Case Type	Emri i ankuesit / Name of complainant	Emri i shkelësit / Name of alleged offender	Komuna / Municipality	Natyra e rastit / Case nature
10	2026-02-12 12:50:00	Ankesë/ Žalba/Complaint	ALEANCA PËR ARDHMERINË E KOSOVËS - AAK - A.E	KQZ	Klina/Klina/Klina	Shpërndarja e ulëseve për kuvend komunal/Raspodela mesta za skupštinu opštine/Distribution of seats for the municipal assembly
80	2026-02-02 10:00:00	Ankesë/ Žalba/Complaint	SRPSKA LISTA	KQZ	Prishtinë/Prishtina/Pristina	Ankesë ndaj vendimit të KQZ-së/ Žalba na odluku CIK-a/ Complaint against CEC decision
79	2026-02-02 09:50:00	Ankesë/ Žalba/Complaint	NOVA DEMOKRATSKA STRANKA - NDS	KQZ	Prishtinë/Prishtina/Pristina	Parregullësi me vota/ Nepravilnosti sa glasovima/ Irregularities with ballots

Statusi / Status	Dokumentet / Documents	Lloji i vendimit / Vrsta odluke/ Decision type	Vendimi i Gjykatës Supreme / Odluka Vrhovnog Suda/ Supreme Court decision
I Vendosur nga PZAP/ Odlučen od IPŽP/ Decided by ECAP	Vendim A10/2026	Refuzohet/Odbijena/Rejected	
I Vendosur nga PZAP/ Odlučen od IPŽP/ Decided by ECAP	ZP.Vendim A80/2026	Miratohet/Usvojena/Decided	
Vendim i Gjykatës Supreme/Odluka Vrhog Suda/Supreme Court Decision	ZP.Vendim A79/2026 ZP.Anr.79-6-2026 Vendim G.J.S.pdf	Refuzohet/Odbijena/Rejected	Refuzohet/Odbijena/Rejected

Gjatë këtij procesi, PZAP-i ka mbajtur mbi 49 panele për shqyrtimin e ankesave të paraqitura, duke respektuar afatet e përcaktuara ligjore. Të gjitha vendimet janë dorëzuar palëve të përfshira në procedurë, në formë fizike dhe elektronike, si dhe janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të PZAP-it. Në përputhje me kompetencat ligjore, PZAP ka shqyrtuar dhe trajtuar 642 ankesa sipas përmbajtjes dhe natyrës së tyre.


Mënyra e vendimmarrjes së PZAP-it:

- Të aprovuara - 248 ankesa;
- Të refuzuara - 245 ankesa
- Të hedhura të palejuara 73 ankesa;
- Të hedhura të pasafatshme 53 ankesa;
- Me shkresë përcjellëse janë dërguar 17 ankesa në Komisionin e Pavarur të Mediave, dhe 2 ankesa në Komisionin e Mediave të Shkruara.

Në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar në mënyrë të detajuar, mënyra e vendimmarrjes nga PZAP-i

Nr	Fazat e procesit zgjedhor	Ankesat e aprovuara	Ankesat e refuzuara	Ankesat e hedhura poshtë të palejuara	Ankesat e hedhura të pasafatshme	Ankesat e tërhequra	Ankesat e përcjellur a në KPM-KMSH	Numri i ankesave të pranuarra Vendosur
1	Para fushata zgjedhore	7	3	15		2		27
2	Fushata zgjedhore	217	175	13	29	2	19	455
3	Dita e Zgjedhjeve	15	53	37	3			108
4	Administrimi i numërimit në QKN dhe QNR	9	8	8	21			46
5	Rezultatet përfundimtare		6					6
Gjithsej		248	245	73	53	4	19	642

Paraqitja grafike



Gjatë zhvillimit të procesit zgjedhor, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ka pranuar një numër të konsiderueshëm ankesash, të cilat pasqyrojnë qartë kompleksitetin dhe dinamikën e çdo faze të zgjedhjeve. Që nga periodha paraprake e para fushatës zgjedhore e deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare, ankesat e adresuara

kanë reflektuar shqetësimet dhe kontestimet e ngritura nga subjektet politike dhe pjesëmarrës të tjerë në proces.

Në periudhën para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore, janë paraqitur gjithsej 27 ankesa, të cilat lidhen kryesisht me parregullsi të evidentuara në prag të nisjes së aktiviteteve zgjedhore. Faza e fushatës zgjedhore, e cila karakterizohet nga një intensitet i lartë veprimesh politike dhe publike, ka rezultuar me 455 ankesa – numri më i madh në të gjithë ciklin zgjedhor – duke dëshmuar sfidat në zbatimin e legjislacionit për zgjedhje të lira dhe të drejta, përfshirë respektimin e Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre.

Gjatë ditës së votimit janë pranuar 108 ankesa, që lidhen me parregullsi, si ndërhyrje të mundshme në procesin e votimit apo incidente të ndryshme në vendvotime. Ndërkohë, në fazën e administrimit të numërimit të votave, si në Qendrat e Numërimit (QKN) ashtu edhe në Qendrën për Numërim dhe Rezultate (QNR), janë trajtuar 46 ankesa që kanë të bëjnë me procesin teknik të numërimit dhe integritetin e të dhënave zgjedhore.

Në fazën përmbyllëse të procesit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), në PZAP janë paraqitur 6 ankesa, të cilat kanë për qëllim kontestimin e rezultateve ose mospajtimin me vendimin përfundimtar të KQZ- së.

Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur të dhënat të cilat pasqyrojnë mënyrën e marrjes së vendimeve nga PZAP-i, lidhur me ankesat të paraqitura sipas fazave të procesit zgjedhor, gjatë Zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 09 Shkurt 2025:

Para fushatës zgjedhore janë parashtruar 27 ankesa shih tabelën e mëposhtme:

Faza e para fushatës zgjedhore		
Nr	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	15
2	Të tërhequra	2
3	Aprovim	7
4	Refuzim	3
Total		27

Gjatë fushatës zgjedhore janë parashtruar 455 Ankesa, shih tabelën e mëposhtme:

Faza e Fushatës zgjedhore		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	12
2	Të tërhequra	2
3	Të pas afatshme	29
4	Aprovim	218
5	Refuzim	175
6	Shkresa përcjellëse KPM-KMSH	19
Total		455

Gjatë Ditës së Zgjedhjeve janë parashtruar 108 Ankesa, shih tabelën e mëposhtme:

Dita e Zgjedhjeve		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	37
2	Të pas afatshme	3
3	Aprovim	15
4	Refuzim	53
Total		108

Gjate administrimit të numërimit në QKN dhe QNR janë parashtruar 46 Ankesa, shih tabelën e mëposhtme:

Administrimi i numërimit në QKN dhe QNR		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	8
2	Të pas afatshme	21
3	Aprovim	9
4	Refuzim	8
Total		46

Gjate Rezultatit Përfundimtar janë parashtruar 6 Ankesa, shih tabelën e mëposhtme:

Rezultati Përfundimtar		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Refuzim	6
Total		6

Natyra e shkeljeve të Procesit Zgjedhor për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës datë 09 Shkurt 2025

Në vijim, përmes tabelave, paraqitet natyra e shkeljeve të evidentuara gjatë fazave të ndryshme të procesit zgjedhor, për Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të mbajtura me datë 09 Shkurt 2025

Nr.	Natyra e shkeljes – Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës 09 Shkurt 2025	Ankesa
1	Mos emërimi i anëtarëve në KKZ, KVV	13
2	Mos përfshirja e votuesve në listën e votuesve jashtë Kosovës	3
3	Mos certifikimi i Subjektit Politik	2
4	Miratimi i listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës	9
5	Ndarja e votuesve brenda qendrave të votimit	1
6	Ndarja e fondeve për subjektin politik	5
7	Përdorimi i gjuhës së urrejtjes në rrjete sociale, debate televizive, tubime zgjedhore	202
8	Pjesëmarrja e Anëtarit të KKZ-së, dhe i KQZ, në tubime zgjedhore	3
9	Shfrytëzimi i institucionit publik për fushatë elektorale në Shkollë, QKMF, Kuvend, Komunë, objekt fetar	47
10	Vendosja e posterave, njoftimeve në hapësira publike në rrugë publike, pritore të autobusëve, brenda ndërtesave publike, brenda oborrit të shkollës, shtyllë elektrike, objekte private pa lejen e pronarit, dhe institucionit	154
11	Pjesëmarrja e fëmijëve në fushatën zgjedhore	25
12	Parregullsi gjate informimit në fushate nga ana e KQZ-së	2
13	Mbajtja e tubimeve me përfaqësues fetar	2
14	Manipulim i votave të votuesve jashtë Kosove	3
15	Shpërblim financiar për fitim të votave	1
16	Shfrytëzimi i pozitës zyrtare për fushatë të subjektit	4
17	Certifikimi i kandidatëve të komunitetit tjetër në një subjekt tjetër	1
18	Mbulim dhe dëmtim të posterave	3
19	Largimi nga lista e votueseve	1
20	Përdorimi i pasurisë publike	4

21	<i>Mos transmetim i spotit të subjektit politik</i>	<i>1</i>
22	<i>Parregullsi gjatë shpërndarjes së numrit të vëzhguesve</i>	<i>1</i>
23	<i>Pengim gjatë mbajtjes së tubimit zgjedhor</i>	<i>1</i>
24	<i>Pengim i gazetarëve për të përmbushur detyrat e tyre profesionale</i>	<i>1</i>
25	<i>Publikim të lajmeve të pavërteta për subjektin politik</i>	<i>1</i>
26	<i>Bartja e votave në subjektin tjetër politik</i>	<i>1</i>
27	<i>Bërja e fushatës gjatë ditës së votimit në çfarëdo mënyre</i>	<i>63</i>
28	<i>Mospërputhje e nënshkrimeve me votat</i>	<i>1</i>
29	<i>Ndarja e mjetit transportues për shpërndarje të materialit zgjedhor nga KKZ</i>	<i>1</i>
30	<i>Parregullsi në vendvotim</i>	<i>35</i>
31	<i>Parregullsi gjatë numërimit në QKN - Dyshime në fletëvotime</i>	<i>1</i>
32	<i>Kërcënim ndaj komisionerës</i>	<i>1</i>
33	<i>Mospërputhje të Votave gjatë administrimit në QKN</i>	<i>1</i>
34	<i>Mos verifikimi i numërimit në mënyrë transparente</i>	<i>1</i>
35	<i>Mungesë e votave gjatë administrimit në QKN dhe QNR</i>	<i>27</i>
36	<i>Parregullsi nga komisionerët</i>	<i>2</i>
37	<i>Refuzimi i zarfeve të fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosove</i>	<i>1</i>
38	<i>Shpallja e fletëvotimeve të pavlefshme</i>	<i>17</i>
Gjithsej		642

Sanksionet ndaj Subjekteve Politike

Gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 9 Shkurt 2025, PZAP-i ka shqiptuar sanksione me gjobë ndaj 16 subjekteve politike, ku ndaj këtyre subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore për shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP) janë marrë 146 vendime sanksionuese, dhe është janë shqiptuar gjoba në vlerë prej 651,100.00 euro.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur gjobat e shqiptuara nga PZAP-i ndaj subjekteve politike


Nr.	Emri i subjektit politik	Shuma e gjobës	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit	Nr.i vendimeve te shqiptuara me gjoba
1	Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK	136,600	136,600	-	30
2	Lëvizja Vetëvendosje-LVV	212,500	212,500	-	47
3	Partia Demokratike e Kosovës-PDK	144,500	144,500	-	28
4	Kualicioni AAK, NISMA-Nisma Social Demokratë, Konservatorët, Intelektualët	72,300	72,300	-	13
5	Partia Liberale Egjiptiane	3,000	3,000	-	2
6	Koalicioni për Familje	18,500	18,500	-	5
7	Demokracia Serbe DS	12,000	12,000	-	3
8	Partia Kosovskih Serba-PKS	7,200	-	7,200	2
9	Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës - IRDK	5,500	5,500	-	3
10	Lista Serbe	26,500	26,500	-	6
11	Nova Demokratska Stranka-NDS	4,000	4,000	-	2
12	Partia Ashkalinjve për Integrim - PAI	1,000	-	1,000	1
13	Nasha Boshnjaqka Kualicia - NBK	1,500	1,500	-	1
14	Slobodu Pravdu i Opsanak-SPO	3,500	3,500	-	1
15	Koalicioni VAKAT	1,500	1,500	-	1
16	Opre Roma Kosova	1,000	1,000	-	1
TOTALI I GJOBAVE:		651,100	642,900	8,200	146

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur natyrat e shkeljeve për të cilat janë shqiptuar gjobat

Nr	Natyrat e shkeljeve për të cilat janë shqiptuar gjobat	Vendime
1	Mbajtja e tubimeve me përfaqësues fetar dhe në objekte fetare	3
2	Manipulim i votave të votuesve jashtë Kosove	1
3	Përdorimi i fëmijëve gjatë fushatës zgjedhore	10
4	Përdorimi i gjuhës (urrejtjes) në tubime rrjete sociale	43
5	Shfrytëzimi i institucionit publik për fushatë elektorale	21
6	Pjesëmarrja e Anëtarit të KKZ-së në tubime zgjedhore	1
7	Vendosja e posterave në hapësirë publike (rrugë publike, shtylla elektrike, objekte publike private)	57

8	Premtime për shpërblime financiare për fitim të votave	1
9	Ndikimi tek votuesit	9
Total		146

Paraqitja grafike



PZAP-i, ka dorëzuar njoftimet për gjobat e papaguara subjekteve politike, të cilat nuk i kanë paguar gjobat e shqiptuara me vendime të PZAP-it, sipas afateve ligjore të parapara sipas legjislacionit zgjedhor, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 9 Shkurt 2025.

Ndalesat Administrative

Përveç gjobave, paneli i PZAP-it me vendim ka ndaluar një anëtar të KKZ-së, nga subjekti politik LVV, që të marrë pjesë në zgjedhje, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor për periudhën kohore, në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite.


Të dhënat me numrin e ankesave të paraqitura nga palët ankuese

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur tabela me të dhënat lidhur me numrin e ankesave të paraqitura, gjatë këtij procesi zgjedhor

Nr.	Pala ankuese	Numri i ankesave
1	Lëvizja Vetëvendosje (LVV)	315
2	Koalicioni PDAK-LPB	5
3	Person fizik	7
4	Lista Serbe	5
5	Gordana Zubiq (anëtare e KQZ-së)	2
6	Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP)	31
7	Socijal Demokratska Unija (SDU)	5
8	Jedinstvena Goranska Partija (JGP)	3
9	Gordana Laban Zubiq (anëtare e KQZ - Lista Serbe)	1
10	Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)	9
11	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	48
12	Srpska Demokratija (SD)	2
13	Koalicioni AAK-NISMA	21
14	Instituti Demokratik i Kosovës (KDI)	9
15	OJQ CEL Kosova dhe Dylberizëm	11
16	Nova Demokratska Stranka (NDS)	6
17	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	104
18	Koalicioni për familje	2
19	Partia Liberale Egjiptiane (PLE)	10
20	Naša Bošnjačka Koalicija (NBK)	3
21	Kompania Fileit L.L.C	1
22	GI Narodna Pravda	2
23	Koalicija VAKAT	2
24	Za Slobodu, Pravdu i Opstanak	4
25	Partia e Ashkanlive për Integrim - PAI	1

26	<i>Partija Kosovskih Srba</i>	11
27	<i>Partia Rome e Bashkuar e Kosovës - PREBK</i>	7
28	<i>KALLXO.COM</i>	1
29	<i>Yenikci Turk Hareket Partisi - YTHP</i>	5
30	<i>BIRN</i>	4
31	<i>OPRE Roma Kosova</i>	1
32	<i>Balli Kombëtar i Kosovës - BKK</i>	1
33	<i>Lidhja e Egjiptianëve të Kosovës - LEK</i>	1
34	<i>Koalicioni PREBK</i>	1
35	<i>Kryesuese e ekipit QKN-A.I Komuna Glogoc</i>	1
Gjithsej		642

Paraqitja grafike



Ankesat e paraqitura ndaj vendimeve të PZAP-it në Gjykatën Supreme të Kosovës


Në bazë të nenit 118.4 të LZP, palët e interesuara mund të paraqesin ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.

Në Zgjedhjet e Rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës të 09 Shkurt 2025, në Gjykatën Supreme të Kosovës prej 642 ankesave të vendosura nga PZAP-i, palët kanë paraqitur 47 ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimeve të PZAP-i, prej të cilave Gjykata Supreme e Kosovës 24 ankesa i ka refuzuar si të pabazuara, 8 ankesa i ka hedhur si të palejuara, 2 ankesa të pasafatshme, 7 ankesa i ka miratuar pjesërisht, dhe 6 ankesa i ka miratuar tërësisht.

Paraqitja në mënyrë tabelore e ankesave në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimeve të PZAP-it

Nr.	Ankesat e paraqitura në PZAP	Vendimet e PZAP-it të ankimuara në Gjykatën Supreme	Të vërtetuara nga Gjykata Supreme	Të hedhur të palejuara nga Gjykata Supreme	Të hedhur të pasafatshme nga Gjykata Supreme	Të ndryshuara nga Gjykata Supreme	Të ndryshuara pjesërisht nga Gjykata Supreme
1	642	47	24	8	2	6	7

Paraqitja grafike



Ankesat kundër vendimeve të KQZ

Gjatë fazës së para fushatës, fushatës zgjedhore, ditës së zgjedhjeve, administrimi i numërimit në QKN dhe QNR, në kuadër të 642 të ankesave janë paraqitur 125 ankesa ndaj vendimeve të KQZ, me natyra si: miratimi i listës së qendrave të votimit jashtë Kosovës, mos emërimi i anëtarëve të KKZ-së, KVV, mos certifikimi i subjektit politik, mos regjistrimi në listën e votuesve jashtë Kosove, ndarja e fondeve për subjektin politik, ndarja e votuesve brenda qendrave të votimit, bartja e votave në subjektin tjetër, dyshime në fletëvotime, largimi nga lista e votueseve, përdorimi i gjuhës (urrejtjes) në tubime, largimi nga lista e votueseve, manipulim i votave të votuesve jashtë Kosove, mospërputhje të votave, refuzimi i zarfeve të fletëvotimeve të votuesve jashtë Kosove, shpallja e fletëvotimeve të pavlefshme etj.

Ankesat e dërguara me Akt përcjellës në Komisionin e Pavarur për Media KPM dhe Këshillin e Mediave të Shkruara

Gjatë këtij procesi zgjedhor në KPM, janë dërguar gjithsej 17 ankesa përmes aktit përcjellës, si dhe dy ankesa në Këshillin e Mediave të Shkruara, të cilat për nga natyra e shkeljes kanë pasur të bëjnë me Përdorimin e gjuhës (urrejtjes) në media, rrjete sociale dhe TV.

Rastet me elemente të veprës penale

Në këtë proces zgjedhor PZAP-i, në Prokurorinë e Shtetit - PSH, nuk ka dorëzuar asnjë rast të ankesave me element të veprës penale.

Raste specifike të identifikuara gjatë procesit zgjedhor të Zgjedhjeve të Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 9 shkurt 2025, Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) është përballur me disa raste specifike të evidentuara gjatë procesit zgjedhor, si në vijim:

- Numërimi i votave të kandidatëve në një qendër të vetme të numërimit, Qendrat e Numërimit Komunal (QKN), si risi me ligjin e ri për zgjedhjet, që ka sjellë sfida praktike dhe procedurale;
- Rritja e ndjeshme e numrit të ankesave që kanë të bëjnë me gjuhën e urrejtjes, çka ka rritur ngarkesën e punës dhe kompleksitetin e shqyrtimit të rasteve;
- Votat me postë, të cilat kanë paraqitur sfida lidhur me administrimin, verifikimin e tyre.

03. PJESA E TRETË

ZHVILLIMI I PROCESIT TË ZGJEDHJEVE LOKALE TË MBAJTURA ME 12 TETOR 2025

Nga shpallja e Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, me dekretin e Presidencës me Nr. Protokolli.22/2025 të datës 09.06.2025, të mbajtura më 12 Tetor 2025, deri në përfundimin e afatit për paraqitjen e ankesave pas administrimit të numërimit të votave në QKN dhe QNR, si dhe për raundin e dytë për Kryetar të Komunave, në PZAP, janë paraqitur gjithsej 440 ankesa, të cilat janë shqyrtuar dhe vendosur brenda afateve të përcaktuara me ligj.

Gjatë këtij procesi, PZAP-i ka mbajtur 35 panele për shqyrtimin e ankesave të paraqitura. Të gjitha vendimet janë dorëzuar palëve ankuese në formë fizike dhe elektronike, janë dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si dhe janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të PZAP-it. Në përputhje me kompetencat ligjore, PZAP ka shqyrtuar dhe trajtuar 440 ankesa sipas përmbajtjes dhe natyrës së tyre të paraqitura.

Mënyra e vendimmarrjes së PZAP-it:

- Të aprovuara - 110 ankesa,
- Të refuzuara - 212 ankesa,
- Të hedhura të palejuara – 42,
- Të hedhura të pasafatshme -75 ankesa
- 1 ankese konstatohet e tërhequr.

Po ashtu në kuadër të numrit të këtyre 440 ankesave, janë ndërmarrë veprimet dhe janë evidentuar rastet si në vijim:

- 5 ankesa janë përcjellë për trajtim në Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM);
- 4 kërkesa janë paraqitur për rishqyrtim të vendimeve të PZAP-it;
- 42 ankesa janë paraqitur në Gjykatën Supreme të Kosovës, ndaj vendimeve të PZAP-it.


Në kuadër të raundit të parë të zgjedhjeve lokale janë paraqitur 419 ankesa, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme sa i përket paraqitjes së tyre në të gjitha fazat e procesit zgjedhor si dhe mënyrën e vendimmarrjes për secilën ankese në Zgjedhjet Lokale 12 tetor 2025.

Ankesat në raundin e parë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 12 tetor 2025

Nr	Fazat e procesit zgjedhor	Ankesa e aprovuara	Ankesat e refuzuara	Ankesat e hedhura poshtë të palejuara	Ankesat e hedhura të pasafatshme	Ankesat e tërhequra	Numri i ankesave të pranuar Vendosur
1	Para fushatës zgjedhore	3	28	3	1		35
2	Gjatë fushatës zgjedhore	91	44	15	16		166
3	Dita e Zgjedhjeve	3	16	5	2		26

4	Administrimi i numërimit në QKN dhe QNR	5	66	15	48		134
5	Shpallja e Rezultateve për kandidatë	5	47	1	4	1	58
Gjithsej		107	201	39	71	1	419

Paraqitja grafike




Ne raundin e dytë të zgjedhjeve lokale janë paraqitur 21 të cilat në tabelën e mëposhtme pasqyrojnë paraqitjen e tyre në të gjitha fazat e procesit zgjedhor si dhe mënyrën e vendimmarrjes

Ankesat në raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura me 9 nëntor 2025

Nr	Zgjedhjet për Kryetar të Komunës – Raundi i dytë i Zgjedhjeve Lokale					
	Fazat e procesit zgjedhor	Ankesa e aprovuara	Ankesat e refuzuara	Ankesat e hedhura poshtë të palejuara	Ankesat e hedhura të pasafatshme	Numri i ankesave të pranuarra Vendosur
1	Fushatë për raundin e dytë	1	2	1	1	5
2	Dita e Zgjedhjeve për Kryetar të Komunës Raundi i dytë	2	8	1		11
3	Shpallja e Rezultateve për Kryetar të Komunës		1	1	3	5
Gjithsej		3	11	3	4	21

Paraqitja grafike



Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur të dhënat të cilat pasqyrojnë mënyrën e marrjes së vendimeve nga PZAP-i, lidhur me ankesat të paraqitura sipas fazave të procesit zgjedhor, gjatë Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më 12 Tetor 2025 dhe zgjedhjet për Raundin e dytë për Kryetar të Komunave të mbajtura me 9 Nëntor 2025.

Në periudhën para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore, janë paraqitur gjithsej 35 ankesa, të cilat lidhen kryesisht me parregullsi të evidentuara në prag të nisjes së aktiviteteve zgjedhore.

Faza e para fushatës zgjedhore		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	3
2	Të pasafatshme	1
3	Aprovim	3
4	Refuzim	28
Gjithsej		35

Faza e fushatës zgjedhore, ka rezultuar me 166 ankesa

Faza e Fushatës zgjedhore		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	15
2	Të pasafatshme	16
3	Aprovim	91
4	Refuzim	44
Gjithsej		166

Faza e Ditës së Zgjedhjeve, ka rezultuar me 26 ankesa

Dita e Zgjedhjeve		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	5
2	Të pasafatshme	2
3	Aprovim	3
4	Refuzim	16
Gjithsej		26

Në fazën e administrimit të numërimit të votave, si në Qendrat e Numërimit (QKN) ashtu edhe në Qendrën për Numërim dhe Rezultate (QNR), janë trajtuar 134 ankesa që kanë të bëjnë me procesin teknik të numërimit dhe integritetin e të dhënave zgjedhore

Administrimi i numërimit në QKN dhe QNR		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	15
2	Të pasafatshme	48
3	Aprovim	5
4	Refuzim	66
Gjithsej		134

Në fazën e shpalljes së Rezultateve për kandidat janë paraqitur 58 ankesa.

Rezultati Përfundimtar për Kandidat të Kuvendeve Komunale		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	1
2	Të pasafatshme	4
3	Të tërhequra	1
4	Aprovim	5
5	Refuzim	47
Gjithsej		58

Raundi i dytë i Zgjedhjeve Lokale për Kryetar të Komunave është mbajtur me 09 Nëntor, ku në fazën e fushatës për raundin e dytë janë paraqitur 5 ankesa.

Fushata zgjedhore për Raundin e Dytë për Kryetar të Komunave		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	1
2	Të pasafatshme	1
3	Aprovim	1
4	Refuzim	2
Gjithsej		5

Në ditë e zgjedhjeve për raundin e dytë janë paraqitur 11 ankesa dhe në fazën e administrimit të numërimit të votave

Dita e Zgjedhjeve për Raundin e Dytë për Kryetar të Komunave		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	1
2	Aprovim	2
3	Refuzim	8
Gjithsej		11

Në fazën e shpalljes së rezultateve për Kryetar të Komunës janë paraqitur 5 ankesa, të cilat kanë për qëllim kontestimin e rezultateve ose mospajtimin me vendimin përfundimtar të KQZ-së

Rezultati Përfundimtar për Raundin e dytë për Kryetar të Komunave		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	1
2	Të pasafatshme	3
3	Refuzim	1
Gjithsej		5

Natyrë e shkeljeve gjatë Procesit Zgjedhor për Zgjedhjet Lokale

Në vijim, përmes tabelave, paraqitet natyra e shkeljeve të evidentuara gjatë fazave të ndryshme të procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datë 12 Tetor 2025

Nr.	Natyrë e shkeljes – Zgjedhjet Lokale 12 Tetor 2025	Ankesa
1	Kërkesë për tërheqje nga lista e certifikuar e subjektit politik	1

2	Kërkesë për tërheqje nga lista e kandidatëve për asamblastët	3
3	Kundër vendimit të KQZ-së për mos certifikimin e kandidaturës për Kryetar Komune	1
4	Kundër vendimit të KQZ-së për mos certifikimin e subjektit politik	4
5	Kundër vendimit të KQZ-së për mos emërimin e anëtarëve të KKZ-së dhe KVV-së	7
6	Kundër vendimit të KQZ-së për mos përfshirjen e komuniteteve në përbërjen e ekipeve të numërimit në QKN	1
7	Kundër vendimit të KQZ-së për mos regjistrimin në listën e votuesve jashtë Kosove	8
8	Kundër vendimit të KQZ-së, për shkak emrit të shënuar ndryshe nga të tjerët në fletëvotim	1
9	Ndikim tek votuesit	5
10	Për shkak të përjashtimit nga lista përfundimtare e votuesve jashtë Kosovës	18
11	Shfrytëzimi i zyrës afër QV	1
12	Vendosja e posterave, bilbordave, afisheve në hapësirë publike, material zgjedhor (objekte, rruge publike, shtylla elektrike, lokale pa autorizim etj.)	79
13	Shfrytëzimi i objekteve/institucioneve , përfaqësuesit zyrtar, burimet publike institucionale për fushatë zgjedhore	19
14	Përdorimi i gjuhës së urrejtjes në tubime politike, debate televizive, rrjete sociale, platforma youtube, kërcënim dhe fjalë fyese ndaj kandidatit të subjektit politik	22
15	Ushtrimi i funksionit publik pas certifikimit si kandidat për asamble komunale	1
16	Parregullsi gjatë fushatës zgjedhore	2
17	Ndikim tek votuesit dhe shpërblim financiar për fitim të votave	2
18	Kundër vendimit të KQZ-së për mos akreditimin e vëzhguesve	17
19	Mashttrim dhe keqinformim ndaj subjektit tjetër politik	3
20	Mbulim dhe dëmtim të posterave dhe vizitkartave reklamues të subjektit dhe kandidatit tjetër	4
21	Marrëveshje të përbashkët jo zyrtare për kandidim të listës për Prishtinën	1
22	Mbajtja e tubimeve me përfaqësues fetar	1
23	Publikimi i fëmijëve në spote për fushatë zgjedhore dhe publikimi në rrjete sociale	3
24	Publikimi i të dhënave personale	1
25	Keqpërdorim i votave nga komisionerët	1
26	Kërcënim dhe përdorim i dhunës ndaj subjektit tjetër politik	1
27	Mospërputhje të rezultatit me procesverbalet e vendvotimit	1

28	Mos njoftimi për ndërrimin e vendvotimit	3
29	Mungesë e votave	2
30	Ndikim te komisionerët në vendvotim	1
31	Parregullsi në vendvotim gjatë ditës së Zgjedhjeve - numër i madh i votimit me asistence	5
32	Ndikimi tek votuesit vendosja e posterave, llogove në Qendër të Votimit facebook, shpërndarja e ushqimit me numër të kandidateve	9
33	Publikimi i spotit zgjedhor në rrjete sociale gjatë ditës së zgjedhjeve	3
34	Parregullsi gjatë numërimit regjistrimit të fletëvotimit të pavlefshëm, i regjistruar si vlefshëm, mungese e votave, parregullsi gjatë regjistrimit të votave të kandidatëve në sistem, parregullsi të vlefshmërisë së votave me post dhe keqpërdorim i asistencës në vendvotim	99
35	Mos posedimi i numrave të shiritave të sigurisë në kutinë e vendvotimit	1
36	Parregullsi gjatë numërimit- Bartja e Votave të një kandidat tjetër	4
37	Dyshime në fletëvotime Parregullsi gjatë numërimit të votave me post QKN-QNR	19
38	Parregullsi gjatë numërimit të votave me kusht	1
39	Mospërputhje të rezultatit me procesverbalet e vendvotimit	1
40	Parregullsi gjatë regjistrimit të votave në sistem	5
41	Parregullsi në listën e kandidatëve - heqja nga lista pa njoftim	1
42	Parregullsi në pranimin e zarfeve nga votuesit jashtë Kosove	1
43	Mos certifikimin e kandidatit të njëjtit subjekt politik	1
44	Parregullsi në ndarjen e mandateve për Kuvend Komunal	2
45	Pjesëmarrja e personave të paautorizuar në VV	1
46	Parregullsi gjatë numërimit(mungesë e votave, numrin e votuesve, mos bartja e votave në FRK, bartja e votave në një kandidat tjetër	40
47	Parregullsi gjatë numërimit në QKN	1
48	Parregullsi gjatë numërimit të votave me postë	4
49	Parregullsi me fletëvotime	1
50	Parregullsi gjatë numërimit-Parregullsi me fletëvotimet e votuesve jashtë Kosove	1
51	Parregullsi në listën përfundimtare për Kuvend Komunal(mospërshirja në listën përfundimtare si anëtar për Kuvendin Komunal, zbatimi i kuotës	3
52	Parregullsi në numrin e anëtarëve për Kuvend Komunal(zvogëlimi i numrit të anëtarëve për Kuvend Komunal të komunitetit jo shumicë, Krahassimi i	6

53	Mospërputhja e votave me votues të komuniteteve	1
54	Moslejimi i mbajtjes së tubimit zgjedhor pas lejit nga KKZ	2
55	Mos përfshirja në listën e votuesve	1
56	Përdorimi i gjuhës së urrejtjes në debate televizive	1
57	Shfrytëzimi i zyrtarit publik dhe institucionit publik gjatë fushatës zgjedhore për balotazh(Kryetar Komune)	1
58	Bërja e fushatës në rrjete sociale gjatë ditës së zgjedhjeve	2
59	Mos përfshirja në listën e votuesve jashtë Kosove mos përfshirja në listën përfundimtare të votuesve në Kosovë)	1
60	Mospërputhja e numrit serik në fletëvotime	1
61	Bërja e fushatës afër Qendrës së Votimit	1
62	Mos shënimi i fletëvotimit të pavlefshëm në librin e vërejtjes	1
63	Parregullsi gjatë votimit	1
64	Parregullsi me materialin zgjedhor në vendvotim fletëvotime dhe udhëzuesi	1
65	Kundër vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar për Kryetar Komune	3
Gjithsej		440

Sanksionet ndaj Subjekteve Politike

Gjatë këtij procesi zgjedhor për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025, përkatësisht gjatë fushatës zgjedhore PZAP-ja përmes 45 vendime ka shqiptuar sanksione me gjobë për 15 subjekte politike, në vlerë prej 124,700.00 euro, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP).

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur shumat e gjobave të shqiptuara nga PZAP-i për Subjekt politike që kanë shkelur dispozitat ligjore


Nr.	Emri i subjektit politik	Shuma e gjobës	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit	Nr.i vendimeve te shqiptuara me gjoba
1	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	10,900	10,900	0	5
2	Lëvizja Vetëvendosje (LVV)	11,300	11,300	0	6
3	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	4,300	4,300	0	5
4	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	3,300	3,300	0	4
5	Iniciativa Qytetare për Skenderajin	17,000	17,000	0	3
6	Socijal Demokratska Unija (SDU)	3,000	3,000	0	1

7	Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës	500	500	0	1
8	GI Novo Lice Narodna Pravda	800	0	800	2
9	Lista Serbe	60,600	60,600	0	11
10	Nova Demokratska Stranka (NDS)	3,500	3,500	0	2
11	Nedzmidin Sejdlar - Kandidat i pavaruar	1,000	1,000	0	1
12	Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP)	500	500	0	1
13	Partia Socialdemokrate (PSD)	1,000	0	1,000	1
14	Slobodu Pravdu i Opstanak (SPO)	4,000	4,000	0	1
15	Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)	3,000	3,000	0	1
TOTALI I GJOBAVE:		124,700	122,900	1,800	45

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur natyrat e shkeljeve për të cilat janë shqiptuar gjobat

Nr	Natyrat e shkeljeve për të cilat janë shqiptura gjobat	Ankesa
1	Bërja e fushatës në rrjete sociale gjatë ditës së zgjedhjeve	2
2	Mbajtja e fushatës në objekte publike	2
3	Mbulim i posterave të subjektit tjetër politik	1
4	Parregullsi gjatë mbajtjes së tubimit zgjedhor	1
5	Përdorimi i gjuhës së urrejtjes në rrjete sociale, debate televizive, tubime politike	8
6	Publikimi i spotit zgjedhor në rrjete sociale gjatë ditës së zgjedhjeve	3
7	Publikimi i fëmijëve në spote për fushatë zgjedhore dhe publikimi në rrjete sociale	1
8	Vendosja e posterave, grafitëve, në hapësirë publike, ndërtesa	20
9	Shfrytëzimi i ambientit të institucionit për fushatë zgjedhore	7
Gjithsej		45

Paraqitja grafike



Të dhënat me numrin e ankesave të paraqitura nga palët ankuese

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur tabela me të dhënat lidhur me numrin e ankesave të paraqitura sipas subjekteve politike, gjatë këtij procesi zgjedhor

Nr.	Palët ankuese	Numri i ankesave
1	Lëvizja Vetëvendosje (LVV)	89
2	Person fizik	28
3	Lista Serbe	12
4	Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP)	5
5	Socijal Demokratska Unija (SDU)	5
6	Jedinstvena Goranska Partija (JGP)	1
7	Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)	2
8	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	49
9	Srpska Demokratija (SD)	1
10	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	14
11	Rrjeti i Organizatave jo Qeveritare AVONET	2
12	Nova Demokratska Stranka (NDS)	4

13	<i>Partia Demokratike e Kosovës (PDK)</i>	79
14	<i>Partia Liberale Egjiptiane (PLE)</i>	2
15	<i>Koalicija VAKAT</i>	2
16	<i>Za Slobodu, Pravdu i Opstanak</i>	15
17	<i>Partia e Ashkanlive për Integrim – PAI</i>	1
18	<i>Kosovskih Savez</i>	3
19	<i>Partia Rome e Bashkuar e Kosovës - PREBK</i>	1
20	<i>Yenikci Turk Hareket Partisi – YTHP</i>	4
21	<i>Për Drenasin Kampion-Ramiz Lladrovci</i>	5
22	<i>Kandidat i Pavarur</i>	12
23	<i>Iniciativa Qytetare-Epoka e Hyjneshës</i>	2
24	<i>Lidhja e Prishtinës</i>	3
27	<i>Lëvizja Qytetare"Vatra"</i>	1
28	<i>Alternativa</i>	1
29	<i>Alternativna</i>	2
30	<i>Centre for Social Inclusion Gracanica (CSIG)</i>	1
31	<i>GI Novo Lice – Narodna Pravda</i>	45
33	<i>GRAÇANICA ONLINE.Info</i>	1
34	<i>OJQ Qendra Rinore Shtime</i>	1
35	<i>R MEDIA L. L. C</i>	1
36	<i>RADIO KIM</i>	1
37	<i>RADIO KM</i>	1
38	<i>REPORT 24.com</i>	1
39	<i>RTV PLUS D.O.O</i>	1
40	<i>Shoqata e grave-Nas Dom</i>	1
41	<i>Shoqata e grave-Nas Dom</i>	1
42	<i>Shoqata Sindikale e Punëtorëve KRU-Hidrodrini</i>	1
43	<i>TV Graçanica D O O</i>	1
44	<i>TV MOST DOO</i>	1
45	<i>Iniciativa Ura</i>	1
46	<i>Iniciativa Demokracia</i>	14
47	<i>Guxo</i>	2
48	<i>Nisma Socialdemokrate</i>	6
49	<i>Partia Shqiptare Demokristiane (PSHDK)</i>	2
50	<i>Partia Social Demokrate</i>	2

51	Vizioni për Zhvillimin e Kaçanikut	2
52	Kandidat për anëtar në Kuvendin Komunal	2
53	Iniciativa për Mitrovicën e Veriut	1
54	Iniciativa Qytetare për Skenderaj	1
55	Mamusa Halk Hareketi	1
56	Vendi Sot	1
57	VIM INFO D.O.O	1
58	KONTAKT KOSOVSKA MITROVICA	1
Total		440

Ankesat e paraqitura ndaj vendimeve të PZAP-it në Gjykatën Supreme të Kosovës


Ne bazë të nenit 118.4 të LZP, palët mund të paraqesin ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.

Në Zgjedhjet e Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me 12 Tetor 2025, në Gjykatën Supreme të Kosovës prej 440 ankesave të vendosura nga PZAP-i, palët kanë paraqitur 42 ankesa në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të PZAP-i, prej të cilave Gjykata Supreme e Kosovës, 40 ankesa i ka refuzuar si të pabazuara gjegjësisht i ka vërtetuar vendimet e PZAP-it, 1 ankesë e ka hedhur të palejuar dhe 1 ankesë e ka miratuar tërësisht gjegjësisht e ka ndryshuar vendimin e PZAP-it.

Paraqitja në mënyrë tabelore e ankesave në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimeve të PZAP-it

Nr	Ankesat e paraqitura në PZAP	Vendimet e PZAP-it të ankimuar në Gjykatën Supreme	Të vërtetuara nga Gjykata Supreme	Të hedhura të palejuara nga Gjykata Supreme	Të ndryshuara nga Gjykata Supreme
1	440	42	40	1	1

Paraqitja grafike



Ankesat kundër vendimeve të KQZ

Gjatë fazës së para fushatës zgjedhore, fushatës zgjedhore, ditës së votimit dhe administrimi i numërimit në QKN dhe QNR, janë paraqitur 252 ankesa ndaj vendimeve të KQZ-së me natyra si: kërkesë për tërheqje nga lista e certifikuar për subjektin politik dhe lista e kandidatëve për asambleiste, kundër vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar për Kryetar Komune, kundër vendimit të KQZ-së për mos akreditimin e vëzhguesve, kundër vendimit të KQZ-së për, mos certifikimin e subjektit politik, listës së kandidatëve të subjektit politik, mos certifikimi i kandidaturës për Kryetar Komune, kundër vendimit të KQZ-së, për mos emërimi i anëtarëve-KKZ, mos emërimi i anëtarëve-KVV, kundër vendimit të KQZ-së, mos përfshirja e komuniteteve në përbërjen e ekipeve të numërimit në QKN, mos përfshirja në listën e votuesve, mospërputhje ndërmjet nënshkrimeve dhe fletëvotimeve, keqpërdorime gjatë procesit të numërimit, kundër vendimit të KQZ-së, mos regjistrimin në listën e votuesve jashtë Kosove, ndarjen e mandateve për Kuvend Komunal, parregullsi në dizajnin e fletëvotimit, heqja nga lista pa njoftim, keqpërdorim të votave, parregullsi në fletëvotime, krahasimi i mandateve me komunat tjera, zbatimi i kuotës gjinore - rinumërimi dhe rivlerësimi i votave, mospërputhja e numrit serik në fletëvotime, mospërputhja e votave me votues të komuniteteve, mospërputhje ndërmjet nënshkrimeve dhe fletëvotimeve, mungesë e votave, parregullsi në QKN numri i madh i asistencës, parregullsi në vendvotim numri i madh i asistencës, pjesëmarrja e personave të paautorizuar në vendvotim, parregullsi në listën e kandidatëve në VV, mungesë e fletëvotimeve nga votuesit jashtë Kosove.

Rastet me elemente të veprës penale

Në këtë proces zgjedhor janë parashtruar disa ankesa natyrave e të cilave kanë të bëjnë me deklaratat e votueseve për subjektin ose kandidatet e caktuar të cilat konsiderohen si cenim i fshehtësisë së votës, andaj PZAP-i, në Prokurorinë e Shtetit-PSH, në mesin e këtyre ankesave ka dorëzuar dy raste.

Rastet specifike të identifikuara gjatë procesit zgjedhor për Zgjedhjet Lokale të datës 12 Tetor 2025.

PZAP-i gjatë trajtimit të ankesave është përballur me disa raste specifike të evidentuara gjatë procesit zgjedhor, si në vijim:

- Siguria e fletëvotimeve, mospërputhja e numrit serik në fletëvotime gjatë printimit
- Deklaratat e votuesve, gjatë parashtrimit të ankesave palët ankuese kishin bashkangjitur në disa raste deklaratat e votuesve me arsyetimin se të njëjtit i kishin votuara,
- Asistenca gjatë votimit; Asistence e shumëfishtë gjatë votimit dhe votim i organizuar familjar me arsyetimet për shkak të paaftësisë- aftësisë së kufizuar për të votuar.

04. PJESA E KATËRT

ZHVILLIMI I PROCESIT TË ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PARLAMENTARE PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS TË MBAJTURA ME 28 DHJETOR 2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), nga fillimi i procesit zgjedhor të shpallur me dekretin e Presidencës me Nr. Protokolli.210/2025 të datës 20.11.2025, ka pranuar gjithsej 80 ankesa, me pretendime për parregullsitë e para fushatës zgjedhore, gjatë fushatës zgjedhore, ditës së votimit, administrimit të numërimit në QKN dhe QNR, dhe rezultatit përfundimtar. Në procesin zgjedhor për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, janë mbajtur 17 seanca të panelit për shqyrtimin e 80 ankesave të parashtruara gjatë këtyre zgjedhjeve. Të gjitha vendimet janë dorëzuar palëve ankuese në formë fizike dhe elektronike, janë dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), si dhe janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të PZAP-it.

Në përputhje me kompetencat ligjore, PZAP ka shqyrtuar dhe trajtuar 80 ankesa të paraqitura sipas përmbajtjes dhe natyrës së tyre.

Mënyra e vendimmarrjes së PZAP-it:

- Të aprovuara - 24 ankesa,
- Të refuzuara - 40 ankesa,
- Të hedhura të palejuara – 8 ankesa
- Të hedhura të pasafatshme – 5 ankesa
- 3 ankesa konstatohen të tërhequra.


Po ashtu në kuadër të numrit të këtyre 80 ankesave, janë ndërmarrë veprimet dhe janë evidentuar rastet si në vijim:

- 1 kërkesë për rishqyrtim është paraqitur ndaj vendimit të PZAP-it;
- 12 ankesa janë paraqitur në Gjykatën Supreme të Kosovës, ndaj vendimeve të PZAP-it

Shih tabelën e mëposhtme me mënyrën e vendimmarrjes

Vendimmarrja e PZAP						
Fazat e procesit zgjedhor	Ankesat e aprovuara	Ankesat e refuzuara	Ankesat e hedhura poshtë të palejuara	Ankesat e hedhura të pasafatshme	Ankesat e tërhequra	Numri i ankesave të pranuar
Para fushatës zgjedhore	6	12	6			24
Gjatë fushatës zgjedhore	13	11		2	2	28
Dita e Zgjedhjeve	4	8	1			13
Administrimi i numërimit në QKN dhe QNR		3	1	3	1	8
Shpallja e Rezultateve përfundimtare	1	6				7
Gjithsej	24	40	8	5	3	80

Paraqitja grafike



Në tabelat e mëposhtme janë paraqitur të dhënat të cilat pasqyrojnë mënyrën e marrjes së vendimeve nga PZAP-i, lidhur me ankesat të paraqitura sipas fazave të procesit zgjedhor, gjatë Zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura me 28 Dhjetor 2025

Në periudhën para fillimit zyrtar të fushatës zgjedhore, janë paraqitur gjithsej 24 ankesa

Faza e para fushatës zgjedhore		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	6
2	Aprovim	6
3	Refuzim	12
Gjithsej		24

Në periudhën e fushatës zgjedhore, janë paraqitur gjithsej 28 ankesa

Faza e Fushatës Zgjedhore		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të pasafatshme	2
2	Aprovim	13
3	Refuzim	11
4	Të tërhequra	2
Gjithsej		28

Në periudhën e ditës së zgjedhjeve, janë paraqitur gjithsej 13 ankesa

Dita e Zgjedhjeve		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	1
2	Aprovim	4
3	Refuzim	8
Gjithsej		13

Në periudhën e Administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR janë paraqitur gjithsej 8 ankesa

Faza e Administrimit dhe Numërimit në QKN dhe QNR		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Të palejuara	1
2	Të tërhequra	1
3	Të pasafatshme	3
4	Refuzim	3
Gjithsej		8

Në periudhën e shpalljes së Rezultateve përfundimtare, janë paraqitur gjithsej 7 ankesa

Faza e shpalljes së rezultateve përfundimtare		
Nr.	Mënyra e vendimmarrjes	Ankesa
1	Aprovim	1
2	Refuzim	6
Gjithsej		7

Natyrë e shkeljeve gjatë Procesit Zgjedhor

Në vijim, përmes tabelave, paraqitet natyra e shkeljeve të evidentuara gjatë fazave të ndryshme të procesit zgjedhor për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës të mbajtura me date 28 Dhjetor 2025

Nr.	Natyrë e shkeljes – Zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Kosovës 28 Dhjetor 2025	Ankesa
1	Kundër vendimit të KQZ-së për mos emërimin e anëtarëve në KKZ-ë	3
2	Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e qendrave të votimit jashtë Kosove, numrin e VV dhe numrin maksimal të votuesve për VV	2

3	<i>Kundër vendimit të KQZ-së për mos certifikimin e Subjektit Politik</i>	1
4	<i>Kundër vendimit KQZ-së lidhje me hartimin e Udhëzuesit për Votimin me Asistencë</i>	1
5	<i>Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e rekomandimit për përbërjen e këshillave të VV në VV e rregullta dhe me kusht.</i>	1
6	<i>Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e përmbajtjes dhe dizajnit të fletëvotimeve në formën që përfshin gjuhën shqipe dhe serbe</i>	1
7	<i>Promovimi i subjektit politik nga anëtarët e KKZ-së</i>	1
8	<i>Kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e rekomandimit për refuzimin e kundërshtimit administrativ</i>	2
9	<i>Kundër vendimit të KQZ-së lidhur me përfaqësimin në Këshillat e Vendvotimeve</i>	5
10	<i>Nxitja e urrejtjes dhe publikimi i fotografisë dhe të dhënave personale ndaj anëtarit të KKZ-së</i>	1
11	<i>Kundër vendimit të KQZ-së për mos certifikimin e listës së kandidatëve të Subjektit Politik</i>	2
12	<i>Kundër vendimit të KQZ-së për mos akreditimin e vëzhguesve(OJQ)</i>	1
13	<i>Përdorimi i gjuhës denigruese në postimin e shkrimeve në rrjete sociale</i>	1
14	<i>Vendosja e materialit promovues në hapësirë publike (rrugë, mbikalim, shtyllë elektrike, stacionin e autobusit, shkolla, sheshe</i>	14
15	<i>Kundër vendimit të KQZ-së për plotësim dhe ndryshim të vendimit për miratimin e rekomandimit për QV dhe numrin e VV në përfaqësi diplomatike</i>	1
16	<i>Shfrytëzimi i resurseve publike të institucionit dhe përfaqësuesve zyrtar gjatë fushatës zgjedhore dhe publikimi në rrjete sociale</i>	5
17	<i>Shpërndarje e videos në rrjete sociale duke ndikuar tek votuesit jashtë Kosove</i>	1
18	<i>Kundër KQZ-së lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve</i>	1
19	<i>Përfshirja e fëmijëve në ngjarje dhe aktivitete politike dhe publikimi në rrjete sociale</i>	3
21	<i>Kundër vendimit të KQZ-së për mos akreditimin e vëzhguesve(Organizata Ndërkombëtare)</i>	1
22	<i>Postimi i kandidatëve të subjektit politik në rrjete sociale për fushatë zgjedhore në pronë publike</i>	1
23	<i>Përdorimi i gjuhës për nxitje të urrejtjes në media</i>	1
24	<i>Vendosja e bilbordit afër Qendrës së Votimit</i>	1
25	<i>Shpërndarje e videos në rrjete sociale duke bërë thirrje për të votuar</i>	1
26	<i>Bërja e fushatës në ditën e zgjedhjeve(sheshin e qytetit pranë selisë së subjektit)</i>	1
27	<i>Mosrealizimi i votimit nga ekipa mobile për personat me nevoja të veçanta</i>	1
28	<i>Ndikim tek votuesit</i>	2
29	<i>Parregullsi në ditën e zgjedhjeve(fotografimi i fletëvotimeve në ekran, përshtime në fletëvotime etj.)</i>	1
30	<i>Parregullsi në QV(votimi dyfishtë, rezultate të dyshimta, emrat e personave të vdekur në listën e votuesve, etj.)</i>	1

31	Postimi i fotografisë në rrjete sociale me slogane politike duke bërë thirrje për të votuar	3
32	Shpërndarje e materialit promovuese në rrjete sociale nga kandidati për deputet për të ndikuar te votuesit	1
33	Thirrje për të votuar	1
34	Vendosja e materialeve promovuese në hapësirë publike(kartela me fotografi të kandidatit, (rrugë, shtylla elektrike, stacione të autobusit, shkolla, objekte publike)	2
35	Mospërputhje e votave të kandidatëve	1
36	Numërimi dhe përfshirja e votave me post në rezultat pas afatit ligjor	1
37	Parregullsi në administrimin ose regjistrimin e votave brenda subjektit politik	1
38	Pjesëmarrja e personave të paautorizuar	1
39	Shpallja e fletëvotimeve të vlefshme pas afatit ligjor	1
40	Parregullsi në fletëvotime(shpallja e fletëvotimit të pavlefshëm nga votat jashtë Kosove)	2
41	Shpërndarje e videos në rrjete sociale duke ndikuar tek votuesit jashtë Kosove dhe mos përfshirja e këtyre votave në rezultat përfundimtar	1
42	Mospërputhje të rezultateve në disa komuna dhe vendvotime	1
43	Kundër vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar-mos përfshirja e rezultatit përfundimtar të subjektit politik	1
44	Kundër vendimit të KQZ-së për shpalljen e rezultatit përfundimtar-	5
Gjithsej		80


Sanksionet ndaj Subjekteve Politike

Gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me 28 Dhjetor 2025, përkatësisht gjatë fushatës zgjedhore, PZAP-ja përmes 11 vendimeve ka shqiptuar sanksione me gjobë për 5 subjekte politike, në vlerë prej 162,000.00 euro, për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP).

Gjobat e shqiptuara nga PZAP-i ndaj subjekteve politike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Kosovës 28 dhjetor-2025

Nr.	Emri i subjektit politik	Shuma e gjobës	Pagesa e gjobës	Mbetja e borxhit	Nr.vend. te shqiptuara
1	Lëvizja Vetëvendosje – LVV	11,500	-	11,500	3
2	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – AAK	1,000	-	1,000	1
3	Partia Liberale Egjiptiane	2,000	-	2,000	1
4	Srpska lista	147,000	-	147,000	5
5	Partia Rome e Bashkuar e Kosovës	500	-	500	1
TOTALI I GJOBAVE:		162,000	-	162,000	11


Paraqitja grafike



Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur natyrat e shkeljeve për të cilat janë shqiptuar gjobat

Natyrat e shkeljeve për të cilat janë shqiptuar gjobat	Ankesa
Vendosja e materialit promovues në hapësirë publike	5
Shpërndarje e videos në rrjete sociale duke ndikuar tek votuesit jashtë Kosove	1
Shfrytëzimi i pozitës zyrtare dhe zyrës së institucionit për fushatë zgjedhore	1
Postimi i fotografisë në rrjete sociale duke bërë thirrje për të votuar	2
Pjesëmarrja e fëmijëve në tubimin për fushatë zgjedhore	1
Thirrje për të votuar	1
Gjithsej	11

Paraqitja grafike




Të dhënat me numrin e ankesave të paraqitura nga palët ankuese

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur tabela me të dhënat lidhur me numrin e ankesave të paraqitura gjatë këtij procesi zgjedhor

Nr.	Palët ankuese	Ankesa
1	Lëvizja Vetëvendosje (LVV)	8
2	Person fizik	5
3	Lista Serbe	6
4	Kosova Demokratik Turk Partisi (KDTP)	3
5	Socijal Demokratska Unija (SDU)	2
6	Jedinstvena Goranska Partija (JGP)	1
7	Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK)	3
8	Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)	8
9	Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës (LPRK)	3
10	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	1
11	Kosovskih Savez	6
12	Nisma Social Demokrate	1
13	Partia Demokratike e Kosovës (PDK)	7
14	Partia Liberale Egjiptiane (PLE)	2
15	Koalicija VAKAT	1
16	Za Slobodu, Pravdu i Opstanak	6

17	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK)	1
18	Anëtar i KQZ-së	1
19	Partia Rome e Bashkuar e Kosovës - PREBK	2
20	OJQ 'Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)	1
21	Shoqata Down Syndrome	1
22	Partia Social Demokratike e Ashkalinjëve (PSA)	1
23	Odbor za Kontrolu i Opservaciju - OKO	1
24	Lëvizja Përparimtare e Romëve të Kosovës(LPRK)	4
25	Koalicioni PAI-PDAK-LPB	3
26	Nova Demokratska Stranka - NDS	2
Total		80

Paraqitja grafike



Ankesat e paraqitura ndaj vendimeve të PZAP-it në Gjykatën Supreme të Kosovës


Në bazë të nenit 118.4 të LZP, palët mund të paraqesin ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda dyzet e tetë (48) orëve nga pranimi i vendimit të PZAP-së, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë se pesë mijë euro (5.000 €), ose në rast se çështja lidhet me një të drejtë themelore. Gjykata Supreme e Kosovës vendos në afatin prej pesë (5) ditësh nga paraqitja e ankesës.

Në Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 28 Dhjetor 2025, prej 80 ankesave të vendosura nga PZAP-i, palët kanë paraqitur 12 ankesa në Gjykatën Supreme kundër vendimeve të PZAP-it, prej të cilave Gjykata Supreme e Kosovës, 11 ankesa i ka refuzuar si të pabazuara gjegjësisht i ka vërtetuar vendimet e PZAP-it, 1 ankesë e ka hedhur të pasafatshme.

Paraqitja në mënyrë tabelore e ankesave në Gjykatën Supreme të Kosovës kundër vendimeve të PZAP-it

Nr.	Ankesat e paraqitura në PZAP	Vendimet e PZAP-it të ankimuara në Gjykatën Supreme	Të vërtetuara nga Gjykata Supreme	Të hedhura të pasafatshme nga Gjykata Supreme
1	80	12	11	1

Paraqitja grafike



Ankesat kundër vendimeve të KQZ

Gjatë fazës së para fushatës, fushatës dhe ditës së zgjedhjeve dhe administrimi i numërimit në QKN dhe QNR. janë paraqitur 33 ankesa me natyrë si : Kundër KQZ-së lidhur me hartimin e Udhëzuesit për Votimin me Asistencë, kundër KQZ-së lidhur me mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, kundër vendimit të KQZ-së lidhur me përfaqësimin në Këshillat e Vendvotimeve, kundër vendimit të KQZ-së për mos certifikimin e subjektit politik, listës së kandidatëve të subjektit politik, kundër vendimit të KQZ-së lidhur me përfshirjen e votave me postë në rezultatin përfundimtar pas afatit ligjor, kundër vendimit të KQZ-së për

miratimin e përmbajtjes dhe dizajnit të fletëvotimeve në formën që përfshin gjuhën shqipe dhe serbe, kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e qendrave të votimit jashtë Kosove, numrin e vendvotimeve dhe numrin maksimal të votuesve për VV, përbërjen e këshillave të VV në VV e rregullta dhe me kusht, kundër vendimit të KQZ-së për miratimin e rekomandimit për refuzimin e kundërshtimit administrativ (Mos regjistrimi në listën e votuesve jashtë Kosove), kundër vendimit të KQZ-së për mos akreditimin e vëzhguesve(OJQ), Organizatë Ndërkombëtare.

Rastet specifike të identifikuara për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvendin e Republikës Kosovës të datës 28 dhjetor 2025. PZAP-i është përballur me disa sfida gjate këtij procesi zgjedhor si në vijim:

- Fletëvotimet dhe materialet tjera në gjuhen turke,
- Caktimi i numrit me të madh të Qendrave të votimit jashtë Kosovës,
- Mos njoftimi nga ana e KQZ-së lidhur me udhëzuesin për personat me aftësi të kufizuara,
- Vendimi PZAP-it, për certifikim të subjekteve politike nga vet PZAP,
- Lista e kandidatëve me deputet të komuniteteve jo shumicë,
- Numërimi dhe përfshirja e votave me postë pas afatit për pranimin e tyre.

PËRFUNDIM

- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP-i duke u bazuar në mandatin e tij të përcaktuar me LQP, Rregullat Zgjedhore, dhe Vendimet e Presidentes për shpalljen e tri proceseve zgjedhore në vitin 2025, me përkushtim e profesionalizëm, dhe me praktikën më të mirë nga zgjedhjet e kaluara, ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të planifikuar aktivitetet dhe angazhuar kapacitetet njerëzore dhe financiare në dispozicion për kryerjen/zbatimin e të gjitha aktiviteteve të nevojshme për pranimin, shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve, komunikimin, transparencën, dhe njoftimin e palëve dhe publikut.
- Anëtarët e PZAP-it, përfshi kryesuesin, gjatë kësaj periudhe prej shpalljes e deri në certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve i kanë dhënë përparësi të plotë obligimeve të tyre si anëtar të PZAP-it, përkundër asaj se nuk ishin liruar nga aktivitetet e rregullta ditore të punës nëpër gjykata, edhe pse kjo është e garantuar me LQP, që 60 ditë para çdo procesi zgjedhor, përparësi duhet t'i jepet punës në PZAP.
- Zyrtarët e sekretariatit të PZAP-it në mbështetje të panelit po ashtu kanë ndihmuar panelin në marrjen e të gjitha vendimeve lidhur me ankesat që janë paraqitur në PZAP, duke siguruar se i tërë materiali i nevojshëm është në dispozicion. Zyrtarët sipas nevojës dhe arsyes janë angazhuar dhe kanë punuar edhe pas orarit të punës si dhe kanë qenë të gatshëm për të kryer të gjitha aktivitetet gjatë gjithë procesit zgjedhor nga dorëzim pranimi i ankesave deri të njoftimi i palëve dhe publikut me vendimet lidhur me ankesat.
- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ka përmbushur me sukses detyrimet ligjore dhe objektivat e përcaktuara në dokumentet planifikuese për vitin 2025, përkundër vështirësive buxhetore dhe mungesës së burimeve njerëzore. PZAP-i ka ndërmarrë të gjitha masat brenda kompetencave të tij për të optimizuar përdorimin e resurseve në dispozicion dhe për të siguruar funksionimin e pa ndërprerë të procesit ankimor dhe vendimmarrës, duke garantuar stabilitet të gjithanshëm të menaxhimit institucional dhe të menaxhimit të gjitha proceseve zgjedhore, të udhëhequr nga profesionalizmi, transparenca dhe komunikimi i vazhdueshëm me shoqërinë civile dhe mediat.
- PZAP mbetet i përkushtuar në ruajtjen e integritetit të procesit zgjedhor dhe trajtimin e drejtë, të pavarur dhe profesional të të gjitha ankesave dhe parashtresave që lidhen me proceset zgjedhore, kurdo që ato mbahen.

SFIDAT NË USHTRIMIN E MANDATIT LIGJOR

- Viti 2025, i karakterizuar nga zhvillimi i tri proceseve zgjedhore, përbën rastin e parë që nga themelimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) në të cilin Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) nuk kanë siguruar ndarje të buxhetit shtesë në kategorinë Mallra dhe Shërbime për realizimin e obligimeve ligjore që rrjedhin nga proceset zgjedhore.
- Si pasojë e mungesës së mjeteve buxhetore, Sekretariati i PZAP-së nuk ka qenë në gjendje të zbatojë Rregulloren Nr. 13/2024 për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), e cila

është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr.12/2025 për Strukturën Organizative dhe Klasifikimin e Pozitave të Sekretariatit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, në të cilën janë paraparë tetë (8) pozita të reja. Mos funksionalizimi i këtyre pozitave ka ndikuar drejtpërdrejt dhe në mënyrë të ndjeshme në kapacitetet administrative dhe operacionale të PZAP-së, veçanërisht gjatë tri proceseve zgjedhore të zhvilluara gjatë vitit 2025, i cili përbënte vit tërësisht zgjedhor.

- Në mungesë të buxhetit shtesë, PZAP ka vepruar ekskluzivisht në kuadër të buxhetit të rregullt vjetor, duke u detyruar të kufizojë aktivitetet dhe angazhimin e burimeve njerëzore. Në këtë kuadër, për Zgjedhjet Parlamentare të mbajtura më 9 shkurt 2025 janë rekrutuar vetëm dhjetë (10) zyrtarë të përkohshëm; për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, përfshirë edhe raundin e dytë, janë rekrutuar vetëm shtatë (7) zyrtarë; ndërsa për procesin e Zgjedhjeve të Parakohshme Parlamentare të mbajtura më 28 dhjetor 2025 nuk është realizuar asnjë rekrutim për shkak të mungesës së mjeteve financiare. Për rrjedhojë, në asnjërin nga proceset zgjedhore nuk është siguruar numri i nevojshëm i stafit, ashtu siç ishte paraparë me kërkesën e aprovuar të PZAP-së, në përputhje me Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Nr. 01/1109, datë 07.11.2024, sipas të cilit për çdo proces zgjedhor ishte planifikuar rekrutimi i tetëmbëdhjetë (18) zyrtarëve të përkohshëm me kohëzgjatje prej tre (3) muajsh.
- PZAP ka hasur vështirësi të theksuara në ushtrimin e mandatit të tij ligjor edhe për shkak të mungesës së hapësirave adekuate të punës, përfshirë kushtet e papërshtatshme për ngrohje dhe klimatizim. Këto rrethana kanë ndikuar negativisht në zhvillimin e paneleve të rregullta, shqyrtimin efikas të ankesave, sigurimin e hapësirave të nevojshme për angazhimin e stafit të përkohshëm, si dhe në përmbushjen e obligimit ligjor për mbajtjen e seancave publike, obligim ky i përcaktuar si kompetencë e re ligjore me Ligjin Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP
Prishtinë, 2026

Rruga “Migjeni“ Ndërtesa e ish Bankës së Lubjanës kati -I-, 10000 Prishtinë

info@pzap-ks.org

www.pzap-ks.org

038/211-242